

Fjalorthi i zoologjisë nga FGJSSH (1980)

Mr. Agim Spahiu

10 mars 2009

Përmbledhje

Ky Fjalorth është nxjerrë në mënyrë elektronike (automatikusht), me anë të programeve: *grep*, *sort*, *uniq*, *awk* etj., duke u mbështetur në **Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe** të vitit 1980.

AFÇË f. Beng.

AKREP I m. 1. Kafshë e vogël helmuese me ngjyrë të zezë, me këmbë nyja-nyja, me dy gëthapë përpara dhe me një thumb të përkulshëm nga pas; sfurkth, përçollak. Akrep i zi. Helmi i akrepit. Vaj akrepi bar që përgatitet me vaj e me helmin e akrepit dhe që përdoret në mjekësinë popullore. Fole akrepash. E hëngri (e pickoi) akrepi.

AKREP UJI Insekt dëmtues, që rron nëpër orizoret dhe që bren rrënjët e orizit.

AME f. shih LOJB/Ë, ~A. Gjuaj ame.

AMEBË f. Kafsha më e thjeshtë njëqelizore, që rron në ujë dhe që ndryshon trajtën gjatë lëvizjes.

ANOFELE f. Lloj mushkonje që mbart mikrobin e malaries, mushkonja e malaries. Larvat e anofeles.

ANTENAGJATË m. Kandërr me trup të vogël, me brirhët të gjatë e me krahët si me gjemb në majë, që dëmton bimët. Antenagjati i jonxhës. Antenagjati i fikut.

ANTENË f.

2. kryes. Secila nga dy fjetet e holla në kokën e disa kandrrave, që shërbejnë si

organe të ndijimit e të nuhatjes; brirth. Çifte antenash.

ANTILOPË f. Gjitar ripërtypës i egër i vendeve të ngrohta të Azisë e të Afrikës, me pamje e madhësi të ndryshme, që ka brirë të gjatë e lëkurë me qime të shkurtër, dhe që vrapon shumë shpejt. Kope antilopash. Lëkurë antilope. Kërcimi i antilopës.

ANTROPOID mb. 1. Që i ngjan njeriut nga pamja e jashtme dhe nga ndërtimi i trupit (për majmunët). Majmunët antropoidë.

2. si em. m. vet. ~Ë, ~ËT. Familje e majmunëve, që i ngjajnë njeriut.

ARAP m.

5. Fulterëz.

ARË f. Miu i arave. Lëroj (ujit) arën. Punon në arë.

ARËZ f. 1. Kandërr e vogël sa bleta, po me trup më të hollë, me ngjyrë të verdhë e me vija të zeza, me thumb helmues; grerëz. Pole (çerdhe) arëzash. Bukë arëzash fole grerëzash si hoje blete.

ARI m. 1. Kafshë e egër gjitare, mishngrënëse, me trup të madh e të rëndë, të mbuluar

- me qime të ashpra, me ngjyrë të murrme a të bardhë. Ariu i murrmë. Ariu i bardhë. Ari pylli. Arinjtë e cirkut. Lëkurë ariu. Putër ariu. Ecën si ari ecën rëndë. Punon si ari punon fort.
- ARUSHË** f. 1. Femra e ariut. Arushë e murrme (e bardhë). Këlyshët e arushës.
- ARRÇ** III m. Dosëz, bushtërz.
- ASTRIT** m. 1. Gjarpër i madh me ngjyrë të verdhë e shpesh i shkruar me pika, që është shumë i shpejtë e i shkathët. Astrit me pika. Hidhet si astrit.
- BABIL** m. Bregcë.
- BAFË** f. Femra e levrekut.
- BAJGUSH** m. Brumbull.
- BAJUKË** f. 1. Shpend i liqeneve dhe i kënetave, i ngjashëm me bajzën, që ka sqep ngjyrë bari dhe lafshë të bardhë. Vrau bajuka.
2. Lopë laramane.
- BAJZË** f. Shpend uji nga familja e rosës së egër, me sqep e me bark të bardhë, me pendë ngjyrë hiri në të zezë e me sy të kuq, që rron në tufë zakonisht buzë liqeneve ose nëpër kënetë dhe ushqehet me peshk. Mish bajze. Një tufë bajzash.
- BAKALARO** f. 1. Peshk i madh i deteve të Veriut, që përdoret si ushqim i tharë e i kripur. Bakalero me hudhra.
- BALDOSË** f. 1. Kafshë gjitare mishngrënëse, me trup të vogël e me turi të zgjatur, me qime të gjata, të ashpra, të murrme në bark e me të çelura në kurriz, që e bën strofkën thellë në dhe; dosëbalë, vjedull. Lëkurë baldose. Strofkë baldose. Si turi baldose.
2. krahin., Dosëz, bushtërz.
- BALENË** f. 1. Kafshë gjitare shumë e madhe, me trup si të peshkut, me gojë shumë të gjerë e me fletëza të birta në vend të dhëmbëve, që jeton në oqeanë e dete dhe gjuhet për mishin e për dhjamin e saj. Balena polare. Balena e kaltër. Balena me dhëmbë.
- BALOSH** m.
2. Shpend uji që jeton nëpër kënetë, më i vogël se rosa, me pupla në ngjyrë të çelur e të bardha në kokë.
- BALTOVEC** m. shih BALTUK, ~U. Gjuaj me baltovecë.
- BALTUK** m. Peshk i vogël, i ngjashëm me sho-jzën, i bardhë, pa hala, me mustaqe e me qime në trup, që jeton në ujëra të ëmbla e me baltë.
- BALUSHË** f.
3. shih BAJZ/Ë, ~A.
- BALLËGJERË** m. Peshk i ujërave të ëmbla, me kokë të madhe e të gjerë dhe me trup të trashë.
- BALLËVERDHË** f. Zog me trup shumë të vogël, me krahë të verdhë, që e ka ballin të kuq me pika të verdha dhe që nuk shtegton në dimër.
- BAR** I m. Zog bari shih te ZOG, ~U.
- BARBUN** m. Peshk deti i vogël, me kokë të madhe e të gjerë, me dy mustaqe të gjata nën gojë, që i ka luspat në ngjyrë të kuqërreme.
- BARBURIQ** m. Peshk i vogël i ujërave të ëmbla, që i ngjan barbunit dhe është me pika të vogla të kuqe.
- BARDHË** mb. Ariu i bardhë. Lepuri i bardhë. Çafka e bardhë. Mëllenja e bardhë. Korbi i bardhë. gallofi. Milingona e bardhë. Miza e bardhë. Krimbi i bardhë. Breshka e bardhë.
- BARI** II m. Shpend notues, me pupla ngjyrë kafe, me sqep si të pulës, që jeton nëpër kënetë dhe ushqehet me peshq të vegjël. Bariu vjen era peshk.
- BARIBOJË** f. Mullibardhë.
- BARISHTOR** m. Lloj kandrrash të vogla, me ngjyrë të verdhë a të kuqërreme, që dëmtojnë bimët barishtore. Barishtori i vogël. Barishtori këmbëkuq. Barishtori barkkuq. Barishtori kokëtrashë.
- BARKARTË** f. Kandërr dëmtuese e bimëve, që e ka barkun të mbuluar me push të verdhë si të pruar. Vemje barkartash.

- BARKGJERË** f. Peshk i vogël i ujërave të ëmbla, me bark të gjerë, skort me vizë.
- BARKKUQE** f.
2. Lloj bretkose me bark si të kuq.
- BARKULEC** m. Peshk i vogël sa cironka, që rron zakonisht në ujëra të njelmëta.
- BAROSKË** f. Zog i larmë me trup sa të mëllenjës.
- BARSHKUMBËS** f. shih SHKUMËZ,~A.
- BELBE** f. Patë e egër, me trup të vogël, që, kur këlthet, nxjerr me ndërprerje një zë të mbytur.
- BELBICË** f. shih BELUSHK/Ë,~A.
- BELUSHKË** f. Troftë më e vogël se korani, në ngjyrë argjendi, që rron në liqenin e Pogradecit. Vezë belushke. Zë belushka.
- BENG** I m. Zog shtegtar sa një harabel, me pupla në ngjyrë të verdhë të ndritur, me krahë të zinj e me sqep të kuq, që ushqehet me fiq; fikës. Tufë bengjesh. Femra e bengut.
- BER** m.
3. Shigjetull
- BERËZ** f.
3. Lloj bishtatundësi me ngjyrë hiri të ndritshme, që i ka këmbët shumë të holla.
- BERONJË** II f. 1. Gjarpër i hollë e i gjatë, që i mbështillet njeriut a shtazës përreth kur do ta hajë; ber, shigjetull.
- BIKËR** f. Fulterëz, bishtfultere.
- BILBIL** m. 1. Zog i vogël shtegtar; me pupla të përhimë në bark dhe te murrme në krahët, që njihet si këngëtari më i mirë ndër gjithë zogjtë. Bilbil pylli. Bilbil uji. Zë bilbili. Kënga e bilbilit. Këndon si bilbil. Fëmija është bilbili i shtëpisë.
- BILBILESHË** f. Fem. BILBIL,~I 1.
- BIRËVESHË** m. shih GËRSHËRËZ,~A 2.
- BIRUES** m. 1. Emër i disa kandrrave dëmtuese, larvat e të cilave shpojnë vrira në pemët. Biruesi i fikut. Biruesi i ullirit. Biruesi i hardhisë. Biruesi i kumbullës.
- BISKAR** m. krahin. Astrit.
- BISKË** f. Rosë e egër me bisht të gjatë.
- BISTËR** f. 1. Peshk deti me trup të hollë e të gjatë si ngjalë; gjilpërëz.
- BISHTAFURKË** f. Nusja e lalës, bukël.
- BISHTAGAN** m. Pilivesë.
- BISHTAGJATË** m. Lloj trishtili me bisht të gjatë, që rron nëpër pyje.
- BISHTAGJEL** m. 1. Lloj rose e egër shtegtare.
- BISHTAKUQ** m. 1. shih BISHTKUQ,~I.
2. Peshk i familjes së krapit, me pendë në ngjyrë të kuqe.
- BISHTANJAKE** f. Lloj peshku me bisht të gjatë, me të cilin godit peshqit e tjerë.
- BISHTARTË** mb. 1. Që e ka ngjyrën e bishtit të verdhë si ar. Flutura bishtartë.
2. si em. BISHTART/Ë,~A f. ~A, ~AT Lloj fluturë, që e ka ngjyrën e bishtit të verdhë si ar.
- BISHTATUNDËS** m. Zog i vogël i rendit të harabelave, me ngjyrë të hirtë dhe me bisht të gjatë, që e tund gjithnjë kur ecën.
- BISHTBARDHË** f. Zog i vogël sa dalëndyshja, që i ka pendët ngjyrë hiri dhe bishtin të bardhë.
- BISHTËRR** f. Bishtfultere.
- BISHTFULTERE** f. Bretkosë e vogël në fillim të zhvillimit të saj, që është një larvë me bisht, bishtlopatë.
- BISHTFURKABUKUR** f. krahin. Nusja e lalës, bukël.
- BISHTGËRSHËRË** f. Lloj rose e egër, që e ka bishtin si gërshtë.

BISHTGJATË mb.

3. si em. BISHTGJAT/Ë,~I m. ~Ë, ~ËT Bishtatundës.

BISHTGJELE f. Rosë e egër që rron afër ujërave, me bisht të gjatë si të gjelit, me qafë të shkurtër e me këmbë të verdha.

BISHTKUQ m. Zog i vogël këngëtar, me bisht si të kuqërremë, që jeton zakonisht nëpër vrimat e ledheve ose të mureve. Bishtkuqi zeshkan. Bishtkuqi i mureve (i ledheve).

BISHTLËKUNDËS m. Bishtatundës.

BISHTLOPATË f. Bishtfultere.

BISHTMËLLENJËZ f. Peshk me trup të shtypur, me sytë të vendosur së bashku nga njëra anë, që rron në fund të detit dhe e ndërton shpejt ngjyrën sipas mjedisit.

BISHTMI m.

2. Peshk deti me trup të shtypur, pak më i gjerë se i gjatë, në ngjyrë të murrme në të hirtë, pa luspa dhe me bisht si grep e të dhëmbëzuar.

BIZON m. Ka i egër i Amerikës Veriore, me trup të madh, me një gungë mbi shpatulla dhe me një kreshtë të dendur në pjesën e përparme të trupit. Kope bizonësh. Gjuetia e bizonëve.

BLERTË mb. Që ka ngjyrën e barit dhe të gjetheve të njoma, i gjelbër. Bar i blertë. Gjethe e blertë. Fushë e blertë. Ngjyrë e blertë.

* Hardhja e blertë zhapiu.

BLETË f. 1. Mizë me krahë, me trup të vogël e të murrmë, të mbuluar me push të verdhë, e cila mbledh nektarin e polenin e luleve dhe bën mjaltin e dyllin. Bletë mjaltëse. Bletë e egër. Bletë punëtore. Mizë blete. Mbretëresha e bletëve. Meshkujt e bletëve. Familje bletësh. Thumbi i bletës. Zgjua (koshere) bletësh. Hoje bletësh.

Zog blete shih te ZOG,~U.

BLI m. Peshk i madh deti me sharrëz mbi kuriz, që e ka mishin të shijshëm dhe që ka vezë të zeza, nga të cilat bëhet havjar i mirë. Bli i bardhë. Bli deti.

BLLOÇKËLOPË f. krahin. Thithëlopë.

BOA f. vet. e shquar, Gjarpër i trashë dhe i gjatë, me trup të fuqishëm, me ngjyrë të murrme në të kuqërreme, që rron në Amerikën Jugore e në Madagaskar dhe që ushqehet me kafshë. Boa shtrënguese. Boa e pyjeve. Boa e ujit.

BOBËL f. 1. Lloj kërmilli që del në pranverë, zakonisht pas shiut. Guaskë boble. Dolën boblat. Ecën si bobla.

BOBËZ f. krahin. Rriqër.

BODRUM m. Merimanga e bodrumeve. Zbres në bodrum. Strehohet në bodrum. Ruaj (mbaj) në bodrum.

BOKË f. Gjarpri i bokës gjarpër i zi, helmues, që rri në vende të thata.

BOKËRR f. Mi fushe në ngjyrë të ndryshkut, që dëmton bimët.

BOLLË f. Gjarpër i trashë johelmues, i gjatë deri një metër e gjysmë, me kokë që nuk dallohet nga qafa dhe me bark të sheshtë, bullar; gjarpër. Bolla e ujit bollujëse. Bolla e kuqe. Bollë shtëpie. I trashë si bollë. Kamxhik prej bolle.

BOLLËSHARDE f. 1. Gjarpër i gjatë rreth dy metra e gjysmë, me lëkurë të trashë, të përhime e lara-lara, që i ngjan bollës.

BOLLËVERBËT f. Gjarpër johelmues, që i ngjan një bolle të vogël dhe që zvarritet si të jetë i verbër.

BOLLUJËSE f. Gjarpër johelmues, i gjatë deri një metër e gjysmë, që jeton në ujë; bollë uji.

BORBOLEC m. krahin. Koshas, vongorec. U dobësua, u bë si borbolec.

BORË f. kryes. nj.

Zog bore. borës, zborak.

BORËS m. Zog i vogël këngëtar sa një trumcak, me krahë të zez, me kurriz të murrme dhe me gjoks të kuqërremë; zogu i borës, zborak.

BORIZAN m.

* Pëllumbi borizan lloj pëllumbi, që e ka bishtin të madh.

BORROVIQ m. Shpend shtegtar, me pendë të bardha a të përhimë, me sqep e këmbë si të lejlekut, që rri pranë ujërave të ëmbla ose në ara të korrura dhe që ushqehet me krimba e me peshk.

BOSTAN m. Pikaloshja e bostanit mollëkuqe.

BOTËGJINATORE f.

2. shih GJINATOR/E,~JA.

BOZHOR m. Pelikan. Fluturojnë bozhorët.

BOZHORE f. Femra e pelikanit.

BREDRURE f. Qukapik.

BREGCË f. Zog i madh sa mëllenja, me pendë të gjelbra, që rron brigjeve të lumenjve; gargull, babil.

BREJTAR m. shih BREJTËS,~I.

BREJTËS m. Kafshë gjitare (si ketri, shqarhi, lepuri, miu etj.), që i ka dhëmbët e parë të zhvilluar e të mprehtë dhe që ushqehet duke brejtur bimë e sende të tjera. Brejtës i vogël. Brejtësit e pyllit. Rendi i brejtësve.

BREJTËS mb. 1. Që ha duke brejtur, që e bren ushqimin; që bën pjesë në rendin e brejtësve. Kafshë brejtëse. Kandërr brejtëse.

BREKAZI m. Brumbull që jeton në pyje ahesh e gështenjash, me trup të zi e të gjatë dhe me dy brirthe të degëzuar si dreri.

BRESHKË f. 1. Kafshë e vogël zvarranike, që e ka trupin të futur në një guaskë kockore pulla-pulla, të rrumbullakët lart dhe të sheshtë poshtë, që ka katër këmbë të shkurtra dhe ecën shumë ngadalë. Breshkë toke. Breshkë uji breshkujëse. Breshkë kënete (deti). Gropë breshkë. Vezë breshkë. Samar (guaskë) breshkë.

Me hapin e breshkës shumë ngadalë. Ecën si breshkë ecën shumë ngadalë. Si kokë breshke.

2. shih BRESHKËZ,~A 2.

BRESHKËZ f. 1. Zvog. e BRESHK/Ë, ~A.

2. Insekt i ngjashëm me morrin, me ngjyra të ndryshme, i mbuluar me një guaskë të hollë, të dylltë e pulla-pulla si guaska e breshkës, që ngjitet zakonisht në gjethe, në degë a nëpër fruta dhe ushqehet me lëngjet e tyre. Breshkëza e butë. Breshkëza dyllore. Breshkëza e bardhë. Breshkëza e kuqe (breshkëza e agrumeve). Breshkëza e zezë. Breshkëza e fikut. Breshkëza e ullirit.

BRESHKUJËSE f. Breshkë që rron në ujë, breshkë uji.

BRETK I m. Mashkulli i bretkosës. Bretk moçali.

BRETKOSË f. Kafshë e vogël pa bisht, me ngjyrë të murrme a të gjelbër, me këmbët e prapme të gjata, që ecën duke kërcyer dhe që mund të jetojë në ujë dhe në tokë. Bretkosë e gjelbër. Bretkosë bari. Zë bretkose. Tufë bretkosash. Këndojnë (kuakin) bretkosat.

BREVË f. Gjarpër johelmues, i gjatë më se një metër, me kurrizin ngjyrëkafe të errët, që e mbyt gjahun duke iu mbështjellë rreth trupit e duke e shtrënguar fort.

BRI m.

2. Secila nga fijet e holla e të shtrira përpara, që kanë disa kafshë të vogla e kandrra dhe që u shërbejnë atyre si organe ndijimesh.

BRICJAP m. Larvë e madhe pa këmbë, me gjoks të gjerë e si trekëndësh dhe me bark konik, që bren drurin.

BRUÇ m. Një lloj bubuzheli dy-tre centimetra i gjatë, me ngjyrë të murrme a të zezë, që dëmton pemët e drurët, sidomos hardhitë.

BRUFULL m. I vogli i qefullit.

BRUMAÇ m. Bruç.

BRUMBULL m. 1. Kandërr me ngjyrë të zezë a të murrme etj., me krahë të fortë e me brirthe të gjatë, që rron nëpër drurë, në pleh etj. Brumbull i vogël. Brumbulli i zi. Brumbulli i murrmë. Brumbulli i gjelbër. Brumbulli i butë. Brumbulli i egër. Brumbull maji. Brumbulli i miellit.

BRYTH m. Urith.

BUALL m.

3. Kacadre.

BUBË I f. 1. Vemje e rritur, para se të shndërrohet në flutur ose në krimb, zakonisht e mbuluar me push, krimbalesh, krimb mëndafshi.

BUBUREZË f. krahin. 1. Mollëkuqe.

2. Xixëllonjë, bukurezë.

BUBURIZË II f. 1. Mollëkuqe.

2. Morr i vogël bimësh e pemësh, zakonisht i gjelbër a me pika.

BUBURREC m. 1. Kandërr me krahë të fortë e me brirthe të gjatë, zakonisht me ngjyrë të zezë a të errët të ndritshme, që rron në plehra, në mure etj.; emër i përgjithshëm për disa kandrra të vogla pa krahë dhe që dëmtojnë bimët. Buburreci i zi. Buburreci i drithërave. Buburreci i duhanit. Buburreci i fasadës. Buburreci i bizeles. Buburreci i patates. Buburreci i ullirit. Buburreci i luleve. Luftimi i buburrecit. Ecën si buburrec. Shtohen si buburrecat.

2. Mizë dheu; milingonë.

3. Bishtfultere.

BUBUZHËL m. Brumbull që rri zakonisht në plehërishte, mbledh plehra topa-topa dhe i rrokullis në folenë e vet.

BUBUZHINGË f. Vizhë.

BUÇ II m. krahin. Gjarpër, nepërkë.

BUF m. 1. Shpend grabitqar i natës, me kokë të madhe e të rumbullakët, me sy të mëdhenj në ballë, me sqep të shkurtër e të kthyer, që rron ndër pyje e në gërmadha dhe që këndon natën sikur vajton.

Bufi veshgjatë. Bufi veshshkurtër. Bufi polar. Buf kënete. Sy bufi. Sheh si buf. Rri si buf.

BUKËL I f. Kafshë e vogël mishngrënëse e familjes së kunadhes, me trup të hollë e të shkathët, me qime të murrme pak si të kuqërreme sipër e të bardha në bark; nuselalë, bishtafurkë. Lëkurë bukle.

BUKUR f.

b) shih PIKËLOR/E,~JA 1.

BUKUROSH mb.

3. si em. ~, ~I m. ~Ë, ~ËT Bish-tatundës.

BULË f. 1. bot., Syth bimësh, mugull; syth që del te disa qenie, prej të cilit zhvillohet qenia e re. Bulat e qershisë (e kumbullës, e plepit). Bulat e hidrës. Çelën bulat.

BULKTH m. Kandërr si karkalec i vogël, me krahë të errët, që rron zakonisht në vrimat e dheut a të mureve të vjetra dhe që natën nxjerr një zë si të gjinkallës. Bulkth nate. Kënga e bulkthit.

BULLAR m. 1. Gjarpër johelmues, me trup të trashë e të gjatë rreth një metër, mjaft i ngathët në lëvizje, që ushqehet me kërmij, minj, zogj etj. Rri si bullari në diell.

BUQICË II f. Zog i vogël sa një trumcak, me ngjyrë të blertë si në të hirtë, që e ndërton çerdhen si të dallëndyshes nëpër guva e shpella.

BURBULEC m. Krimb që rritet nën lëkurën e disa kafshëve ose në ujë të ndenjtur. Kishte zënë burbulecë delja.

BUSHTËR f.

4. shih DOSËZ,~A.

BUSHTËRZ f. shih DOSËZ,~A.

BUTAK m. Tip kafshësh të vogla me trup të butë, pa skelet e të mbuluar me një cipë të përjargur, që kanë zakonisht një guaskë mbrojtëse dhe që rrojnë kryesisht në ujëra të kripura e të ëmbla; molusk. Butakë uji (deti). Butakë toke. Butakë me (pa) guaskë.

BUZËKUQE f. 1. Tartabiqe.

2. Mollëkuqe.

- BUZOÇ** m. shih VIJOSH,~I.
- BYR** m. Urith.
- CAKORRE** f. 1. Sëpatë e vogël, latore, naxhake. Cakorre e mprehtë. Pres me cakorre. E goditi (i ra) me cakorre.
2. Kocë e vogël.
- CEFALOPODË** m. vet. Klasa më e lartë e butakëve të detit, të cilët kanë rreth kokës zgjatime me ventuza, që i përdorin si këmbë për të lëvizur ose për të kapur ushqimin. Klasa e cefalopodëve.
- CETACE** f. vet. Rend i gjitarëve të detit (si balena, delfini etj.) që e kanë trupin si peshk i madh dhe që marrin frymë me mushkëri.
- CËPËZ** f. Zog me trupin sa të mullenjës, me ngjyrë të murrme në të hirtë, që rri në vende moçalore e në plehërishta.
- CËRRE** f. shih CIRL/Ë,~A.
- CIGAREPËRDREDHËS** m. shih CIGARTOR,~I.
Cigarepërdredhësi i hardhisë.
- CIGARTOR** m. Kandërr e vogël me krahë të gjelbër ose të kaltër e me shkëlqim metalik, që del në pranverë, bren sythat e hardhisë e të pemëve të tjera dhe mbështillet si cigare me gjethen e tyre. I bren si cigartor.
- CIKË** f. Zog pak më i madh se trumcaku, që rron nëpër ara dhe që i ka pendët e krahëve të përhime në të verdhë e me pika të murrme, ndërsa ato të barkut të bardheme në të verdhë.
- CIKLOP** m.
2. Lloj gaforreje grabitqare, me trup të vogël e të zgjatur dhe me një sy përpara, që rron në ujëra të ndenjura ose në shtresat e sipërme të ujërave të detit.
- CIKOFUA** m. Beng.
- CIMBUR** m. krahin. Këpushë.
- CINGUSH** m. Zog i vogël, me kokë të madhe, me pendë në ngjyra të ndryshme, që rron zakonisht në pyje.
- CINXËR** m. 1. Gjinkallë. Këndon cinxri. Flet si cinxër nuk pushon së foluri.
2. krahin. shih BULKTH,~I.
- CIQE** f. Zog pak më i vogël se cirila, me bisht të gjatë, me pendë të murrme nga sipër e të kuqërremta nga poshtë, që rri nëpër ferra.
- CIRIKOKË** f. Stërqokë.
- CIRIPUPE** f. 1. Zog me pendë të murrme më të bardhë, më i vogël se laraska, që ecën duke kërcyer; çililingë. Mos ta mundtë qyqja, se ta mund edhe ciripupja. fj. u.
- CIRLË** f. Zog si mullenja, me pendë të murrme e me pika të errëta ose të çelëta. Cirlë fushe mullibardhë. Cirlë verdhashe. Zë cirila.
- CIRLUA** m. krahin. Shturë, gargull.
- CIRONKË** f. 1. Peshk i familjes së krapit, me trup të vogël e të mbuluar me luspa të ndritshme, që rron në ujëra të ëmbla; gjuhçë. Cironka të thara (të kripura).
2. Peshk i vogël, i parritur. Zë një cironkë.
- CIRUA** m. 1. shih CIRONK/Ë,~A. I vogël si cirua.
- CJAP** m. Mashkulli i dhisë. Cjap i bardhë. Cjap shyt. Cjap pa brirë. Mish cjapi. Lëkurë cjapi. Cjapi edhe pa mjekër cjap mbetet. fj.u.
- CJAP** I EGËR Kafshë përtypëse e ngjashme me cjapin, me brirë të gjatë që rron në male të larta e të thepisura.
- CUMËR** II m. Lloj qefulli me trup boshtor e të zhdërvjellët, qefulli i verës, gushtak.
- CUMRAK** II m. Cumër i vogël
- CYLEK** m. Kllinzë. Cylek gropash.
- ÇAFËR** I m. 1. Peshk pendëkuq i ujërave të ëmbla, i gjatë një pëllëmbë, me bark të gjerë e me shumë hala.
- ÇAFKË** I f. 1. Shpend uji, që ka qafë të gjatë e këmbë të gjata, sqep të hollë dhe një tufë puplash të zeza në krye; gatë. Çafka e bardhë. Çafka e kuqe. Çafka e përhime. Çafkë deti.

- ÇAFKËBARDHË** f. Shpend uji me sqep e me qafë pak me të shkurtër se të çafkës dhe me pendë të bardha.
- ÇAFKËLORE** f. 1. Zog këngëtar më i madh se harabeli, me ngjyrë të murrme, me një xhufkë pendësh në majë të kokës, që jeton arave; laureshë. Kënga e çafkëloreve. Ngrihen çafkëloret.
2. Pulë me një xhufkë pendësh të gjata në maje të kokës, pulë me çafkë.
- ÇAFKËTHIME** f. Çafkë me pendë të përhime.
- ÇAFKORE** f. shih ÇAFKËLOR/E,~JA I.
- ÇAJME** f. 1. Çafkë, gatë. Çajme e kuqe. Tufë çajmesh.
2. Shpend grabitqar e këngëtar, i ngjashëm me harabelin, që ushqehet me kandrra. Çajme rrushi çajme që ushqehet me kokrra larushku.
- ÇAKALL** m. sh 1. Kafshë gjitarë grabitqare më e vogël se ujku, me qime të kuqërreme, që ushqehet zakonisht me ngordhësira dhe që nxjerr një angullimë të fortë. Tufë çakejsh. Ulërima (angullima) e çakallit. Hante si çakall.
- ÇAUSH** m. hist. Zog çausht shih te ZOG,~U.
- ÇEKIÇ** THNEGLASH Qukapiku.
- ÇERR** m. 1. Cinxami, ferrak. Tufë çerrash. I vogël sa një çerr. Ha si çerr ha shumë pak.
2. Zog i vogël pule, zakonisht i nxjerrë nga një shpend tjetër shtëpiak.
- ÇIKË** I f.
8. krahin. Xixëllonjë. Çikat e natës. Dolën çikat.
- ÇIKË** III f. Zog i vogël shtegtar që i ka puplat ngjyrë ulliri në pjesën e sipërme të trupit, të bardha në të verdhë në pjesën e poshtme.
* ÇIKË E VOGËL Zog i vogël me kaçule të verdhë në majë të kokës, me pupla ngjyrë ulliri në pjesën e sipërme të trupit dhe me dy rripa të bardhë e të hollë në krahe.
- ÇIKËRR** m. Karkalec.
- ÇIKËVERË** f. krahin. Xixëllonjë. Dolën çikëverat.
- ÇILILINGË** f. shih CIRIPUP/E,~JA.
- ÇIMËRR** f. krahin. Çimkë, tartabiqe.
- ÇIMKË** f. 1. Kandërr e vogël me trup të rumbullakët të shtypur, me ngjyrë të kuqe të errët e me një erë të keqe, që jeton si parazit nëpër plasat e dhomave e të orendive shtëpiake dhe që u thith njerëzve gjakun kur flenë; tartabiqe. Bar çimkash. Erë çimke. Mbyt (zhduk) çimkat.
- ÇINËRR** f. Zog i vogël këngëtar sa një cinxami, me kokë të zezë e me sqep të mprehtë, me pendët e trupit të hirta në pjesën e sipërme e të verdha në anët e në gjoks, i cili e bën folenë zakonisht në zgavrat e drurëve. Kënga e çinrrave. Fole çinrrash.
- ÇOÇËR** m. 1. Cinxami.
- ÇOTË** f. 1. Grifshë.
2. Femra e gjonit.
- ÇUÇ** m. I vogli i disa shpendëve, i cili sapo ka dalë nga veza; zog i porsadale. Çuçat e kllaçkës. Fole me çuçat zogjsh.
* ÇUÇ GOMARI Lloj zogu me sqep të trashë.
- DAC** DETI Lloj peshkaqeni me kokë të gjerë, me trup në ngjyrë të çelur e me pika të murrme.
- DAC** I EGËR Rrëqebull.
- DALLËNDYSHE** DETI Lloj peshku, që rron zakonisht në fund të detit.
- DARDHË** f. Shushunja e dardhës shih te SHUSHUNJ/Ë,~A.
- DASH** DETI Pelikan.
- DEJKË** f. Zog shtegtar i ngjashëm me dallëndyshen, me pupla të murrme, që fluturon shumë shpejt dhe që e bën folenë zakonisht në ndërtesat e larta. Fole dejkash. I shpejtë si dejka.
- DELMERE** II f. Bishtatundës.

DERVISH m.

4., krahin. Çafkëlore. Fluturonin dervishët.

DERR DETI Gjitar mishngrënës që jeton në det, më i vogël se delfini, me një feçkë të gjerë e të rrumbullakët dhe me fletë trekëndëshe.

DERRKUC m.

* **DERRKUC INDIE** Kafshë e vogël brejtëse me lëkurë të lëmuar e me veshë të rrumbullakët, që e ka prejardhjen nga Amerika e Jugut.

DET m. Gështenjë deti. Guaskë (gocë) deti. Iriq deti. Kali i detit. Kandil deti. Karkalec deti. Lakër deti. bot. Lopë deti. Luani i detit. Plesht deti. Qen deti. Trëndafil deti. Yll deti.

Dash deti shih te **DASH**, ~I. Gjël deti shih te **GJEL**, ~I. Pulë deti shih te **PUL/Ë**, ~A

DEVE f. 1. Kafshë përtpëse trupmadhe me këmbë të gjata, me qafë të gjatë e të përkulur, me kokë të vogël dhe me një gungë ose me dy gunga në kurriz, që përdoret në shkretëtira e në stepa të thata si kafshë ngarkesë. Deve me një gungë (me dy gunga). Lesh (mish, qumësht) deveje. Karvan devesh.

DIMËR m. Zog dimri (zog bore) shih te **ZOG**, ~U.

DIMËRAK m. Borës.

DJERRADITËZ f. mospërf. Mashkulli i bletës, brumbull.

DOSË II f. shih **DOSËZ**, ~A.

DOSËBALË f. Baldosë. Lëkurë dosëbale.

DOSËZ f. Kandërr e ngjashme me bulkthin, me trup të gjatë deri pesë centimetra e të mbuluar me push të imët, me brirë të trashë dhe me thonj të fuqishëm, e cila rri zakonisht brenda në tokë e dëmton rrënjët e bimëve bujqësore; arrç, bushtërz, këlysh dheu.

DRANGË f. Peshk i ujërave të ëmbla, me trup të gjatë e me hala, që peshon deri një gjysmë kilogrami, lloskë.

DRE m. 1. Kafshë gjitare përtpëse e dythundrake, me brirë të gjatë ose të degëzuar (te mashkulli), që rron në tufa nëpër pyje malore. Bri dreri. Gjurmë dreri. Gjuetia e drerëve. I shkathët (i shpejtë) si dre.

DREDHËS II m. Dre mashkull me brirë të degëzuar.

DREJTFLATORË m. vet. Rend i kandrrave që i kanë krahët e përparmë të kryqëzuar njërin mbi tjetrin dhe të prapmit të palosur gjatazi; kandrrat që bëjnë pjesë në këtë rend (si bulkthi, karkaleci, dosëza etj.).

DRENUSHË f. 1. Femra e drerit, sutë.

DRENJË f. Shkurtë. Drenja gushëkuqe.

DRITHË m. Miza e drithërave. Sharruesi i drithërave. Shushunja e drithërave. Tenja e drithërave.

DRITHËNGRËNËS mb. Që i ha ose i dëmton drithërat (për kandrra). Kandërr drithëngrënës.

DRIZAK m. Zog me trup sa të mullenjës, në ngjyrë kafe të çelët, që e bën folenë nëpër driza.

DRUNGRËNËS mb. 1. Që ha drurin e pemëve dhe e bën vrima-vrima, që bren drurët (për disa kandrra e vemje).

2. si em. ~, ~I m. ~, ~IT. Kandërr a vemje drungrënës.

DUDI f. 1. Kumri. Këndon dudia.

DUHAN m. Brumbulli (buburreci) i duhanit.

DYFLATORË f. vet. Rend kandrrash me dy krahë, që kanë në kokë një thumb për të pickuar e për të thithur.

DYTHUNDRAK mb.

2. si em. ~Ë, ~ËT m. vet. Kafshët përtpëse, si lopa, derri, dreri etj., që e kanë thundrën të çarë me dysh. Rritja e dythundrakëve.

DYZETKËMBËSH m. Shumëkëmbësh.

DHE m. sh Këlysh dheu shih te KËLYSH,~I. Kërp dheu shih te KËRP,~I. Mizë dheu milingonë.

DHËMBËSUTË f. Guaskë e vogël deti e bardhë, e fortë, e shkëlqyer dhe e ngjashme me një dhëmb sute.

DHI E EGËR a) Kafshë gjitare përtypëse e ngjashme me dhinë, me brirë shumë të gjatë e shumë e zhdërvjellët, e cila jeton zakonisht në male të larta e të thepisura.

DHJETËKËMBËSH mb. 1. Që ka dhjetë këmbë, me dhjetë këmbë. Kafshë dhjetëkëmbëshe.

EGËR mb.

* Dac i egër shih te DAC,~I. Dhi e egër shih te DHI,~A. Elb i egër bot. shih tek ELB,~I. Gjël i egër shih te GJEL,~I. Mace e egër shih te MAC/E,~JA.

ELEFANT m. 1. Kafshë gjitare e viseve të ngrohta të Afrikës e të Azisë, me trup shumë të madh e të rëndë, me veshë të gjerë, me feçkë të gjatë dhe me dhëmbë të mëdhenj e të kthyer. Elefant i zi (i murrinë). Elefanti i Afrikës (i Azisë). Dhëmbë elefanti. Tufë elefantësh. Gjuetia e elefantëve.

* ELEFANT DETI Lloj foke me feçkë si të elefantit.

ELEKTRIK m. 1. bised. Energji elektrike, rrymë elektrike; dritë elektrike. Tel elektriku.

Çelës elektriku. Sahat elektriku. Ndrriçohet (punon) me elektrik.

2. Mjet me trajta e përmasa të ndryshme, i pajisur me bateri elektrike e me një llambë të vogël, që përdoret për ndriçim; bised. llambë elektrike. Elektrik dore (xhepi). I ndërroj llambën elektrikut. Ndez (shuaj) elektrikut.

* Elektrik deti bised. peshk elektrik.

ENDËZ II f.

2. Vezët që lëshon miza në mish, në peshk etj.

3. Lloj fluturë e vogël, si mushkonja, që zakonisht fluturon në tufë bashkë me të tjera e që ushqehet kryesisht me nektarin e luleve. Endëza e pishës.

ERAK m. Zog i egër grabitqar, i ngjashëm me bufin, po me trup me të vogël, që jeton gjithnjë në vetmi e që mund të qëndrojë në ajër pa lëvizur krahët.

ESH m. krahin. 1. Iriq. U mblodh si esh.

FAJKORE I f. Femra e fajkoit.

FAJKUA m. 1. Shpend grabitqar me krahë të mëdhenj, me sqep të shkurtër e të kthyer, me kthetra të forta dhe me bisht të bardhë; skifter. Fluturonte si fajkoi. U sul si fajkua.

FAQEKUQ m. Kryeartëz.

FARË f.

4. Veza e disa kandrrave ose e disa kafshëve, nga e cila zhvillohet larva.

FARËNGRËNËS m. Buburrec i vogël, në ngjyrë të zezë, që ha farat e bimëve. Farëngrënësi i tërfillit.

FARJE f.

2. Matka e bletës, parëz.

FASULE f. bot. Miza e fasules. Mish me fasule. Mbledh (shkoq) fasulet.

FAZAN m. Shpend i egër, me trup sa të gjelit, me bisht të gjatë, me pupla të bukura shumëngjyrëshe, që gjuhet për mishin e tij të shijshëm; mishi i këtij shpendi i gatuar si gjellë. Fazan mashkull (femër). Fazan i pjekur. Pendë (vezë) fazani.

FEÇKOR m. Kandërr me kokë të zgjatur si feçkë, që bren sythet e bimëve a të pemëve ose shpon frytet e tyre e i bën vrima-vrima. Feçkori i mollës. Feçkori i lajthisë. Feçkori i luleshtrydhes.

FERRACAK m. Peshk i vogël me hala, që ka gjemba në shpinë e në bark në vend të fletëve notuese; një lloj krapit i vogël.

FERRAK m. Cinxami.

FERRË f. Zog ferre (miu, shtrige) shih te ZOG,~U.

- FERRËGJATË** m. Gjitar nga rendi i brejtësve, që e ka shpinën të mbuluar me gjemba të fortë e me të gjatë se të iriqit.
- FERRËS** m. Cinxami.
- FIERKUQE** f. Gjarpër i madh helmues, me lëkurë të kuqe, që jeton nëpër fierishta.
- FIKËS** II m. Beng.
- FIL** I m. 1. Elefant.
- FILOKSERË** f. Kandërr e vogël parazite, e ngjashme me morrin e bimëve, e cila dëmton rëndë sidomos hardhitë. Filoksera e hardhisë. Filoksera e gjetheve (e rrënjëve).
- FIQFIQ** m. Zog i vogël që nxjerr një cicërimë të hollë.
- FISHNJAR** m. Kafshë mishngrënëse e ngjashme me shqarthin, me qime të murme e me një njollë të bardhë në kraharor, me bisht shumë të gjatë e me këmbë të shkurtra, që gjuhet për lëkurën e saj të çmuar.
- FLUTUR** f. 1. Emërtim i përgjithshëm për disa lloje kandrrash fluturuese, me katër krahë të mbuluar me luspa të imëta si pluhur, me ngjyra të ndryshme, me feçkë e brirthe për të thithur dhe për të ndier, disa prej të cilave dëmtojnë bimët. Flutur shumëngjyrëshe. Flutur bishtartë. Flutur mashkull (femër). Flutura e bardhë e pemëve. Flutura e verdhë e jonxhës. Flutur nate. Flutura e mëndafshit. Flutura e lakrës. Flutura e duhanit. Flutura e misrit. Flutura e orizit. Flutura e hambarëve. Flutura e gjembave. Krahët e fluturës. Brirthët e fluturës. Vezë fluturash. Ndjek fluturat. Kap (zë) flutura.
2. Krimb i shtypur si gjethe e vogël që rron në gypat e mëlçisë së zezë zakonisht te dhentë dhe shkakton sëmundjen e këlbazës. Flutura e këlbazës.
- FLUTURAK** mb. Peshk fluturak (fluturues) shih te PESHK. ~U.
- FLUTURUES** mb. Peshk fluturues (fluturak) shih te PESHK, ~U.
- FOKË** I f. 1. Gjitar i deteve polare, me trup të madh e me qafë të shkurtër, me këmbë si lopatë, me lëkurë të mbuluar me qime të shkurtra, që ushqehet me peshq dhe që gjuhet zakonisht për t'i marrë dhjamin e lëkurës. Mish (dhjamë, lëkurë) fokë. Gjuetia e fokave. Është si fokë.
2. bised. mospërf. Njeri i trashë, i rëndë e i ngathët, që mezi lëviz.
- FREGATË** f.
3. Shpend i fuqishëm që jeton në ishujt e oqeanëve e në detet tropikale, me krahë të mprehtë, me bisht të gjatë e të bigëzuar dhe me sqep të madh e të kthyer në majë; shqiponjë deti. Fluturojnë fregatat në stuhi.
- FRUTË** f.
- * Shpuesi i frutave shih te SHPUES, ~I.
- FUGË** I f. 1. Femra e bengut.
- FULTERËZ** f. I vogli i bretkosës në fazën e parë të zhvillimit të tij, që ka një kokë të imët e të zezë dhe një bisht të gjatë. Lëvrinin fulterëzat.
- FURUVEJKË** f. Kukuvačkë.
- FURRËBUBËZ** f. Nusja e lalës, bukla.
- FURRTARE** f. Lloj kandrrë si brumbull, zakonisht e zezë ose e kuqë-rreme, që rron nëpër shtëpi e në vende ku mbahen ushqime dhe del natën për të ngrënë mbeturinat e ushqimeve; zhuzhull. Furrarja e zezë. Furrarja e kuqe (kuqalloshe). Kanë dalë furrtare. Zhduk furraret.
- GABONJË** f. krahin. Shkabë.
- GAFORRE** f. Kafshë e ujërave të ëmbla e të kripura, që e ka trupin të mbuluar me një guaskë të fortë, me dhjetë këmbë të nyjëzuara e me kthetra në majë, të cilat i japin mundësi të ecë në të gjitha drejtimet. Gaforre e kuqe. Gaforre lumi (deti). Gjuajtës gaforresh. Zvarritet (ecën) si gaforre.
- GALABUN** m. Krimb mëndafshi që nis të bëjë fshikëzën, por nuk arrin ta mbarojë.
- GALË** f. 1. Stërqokë. Tufë galash. Fluturojnë galat.

- GALLOF** m. 1. Korbi i bardhë.
- GAMILE** f. Deve. Gamile me një gungë (me dy gunga). Karvan me gamile.
- GARDALINË** f. Kryeartëz. Kënga e gardalinës. Këndojnë gardalinat.
- GARGALIQ** m. Kafshë e vogël si bretkose, që jeton në ujë e në tokë, me kurriz në ngjyrë të gjelbër të hapët, me barkun të bardhë e me dy vija të murrme anëve.
- GARGË** I f. Bregcë.
- GARGULL** m. 1. Bregcë.
2. Shturë.
- GATË** f. Shpend uji, që jeton nëpër moçale e kënetat, me qafë e me sqep të gjatë dhe me një tufë puplash të zeza në krye; çafkë.
- GAZELË** f. Dhi e egër, me trup të shkathët e të bukur, që rron në Afrikë e në Azi.
- GËRMUQ** m. Drangë. Gërmuqë ka shumë.
- GËRSHËRËZ** f.
2. Insekt i vogël, me trup të hollë e të gjatë në ngjyrë kafe të errët, me bishtin bigë e me dy brirthe në kokë, që ushqehet me pemë e sidomos me rrush.
- GËRTHAC** I m. Greth.
- GËRTHAP** m.
2. Kandërr me dy grepa të fortë si brirë përpara e me dy palë krahë, që rri nëpër zgërbonja drurësh.
- GËRTHIULË** f. Pupëz.
- GËRTHJE** f. krahin. 1. Gaforre. Gërthje lumi. E kapi gërthja.
- GËSHTENJË** DETI Iriq deti.
- GLISTËR** f. 1. Krimb unazor në ngjyrë të mishit që rron në vende me lagështirë, në pleh etj. dhe që zakonisht del pas shiut, krimbi i tokës, krimb shiu; karrem. Shtyp një glistër. Zë peshk me glistër.
2. Parazit që jeton në zorrët e njeriut a të kafshëve, rre. Glistrat e zorrëve. Nxjerr glistra. Bar glistrash.
- GOÇË** II f. Butak i vogël deti, i mbështjellë me një guaskë të fortë e të ndritshme, të ndarë në dy pjesë; guaska që mbështjell këtë butak. Goca të bardha (të zeza). Goca deti.
- GOGESH** m. Pëllumb i egër. Fluturojnë gogeshët. Vrau një gogesh.
- GOGOZHEL** m.
3. Bubuzhel.
- GOLLOMESH** m. shih LAKURIQËS,~I 1. Gollomeshi i natës.
- GOMAR** m. Çuç gomari shih te ÇUÇ,~I.
- GOMAREZ** f.
3. krahin. Brumbull.
- GORILLË** f. Majmun i madh pa bisht, që rron zakonisht në pyjet e Afrikës Perëndimore dhe që i ngjan shumë njeriut. Është si gorillë.
- GRERË** f. Grerëz.
- GRERËZ** f. 1. Kandërr si bleta, po me trap më të vogël e më të hollë, në ngjyrë të verdhë e me vija të zeza, që ka një thumb helmues; arëz. Grerëza e kumbullës (e dardhës, e mollës). Fole grerëzash. Thumbi i grerëzës. E thumboi (e pickoi) grerëza.
- GRETH** m. 1. Arëz me trup të madh, me ngjyrë të murrme në të kuqe, me bark të verdhë e me një thumb helmues; grerëz. Fole grethash. E pickoi grethi.
- GRIFË** f. sh,
2. Shpend i madh grabitqar, me trup ngjyrëkafe të ndezur, me kokë e qafë të bardhë, me sqep të madh e të fortë, që ka në këmbë nga katër kthetra, jeton në shkëmbinj ose nëpër pemë të vetmuara dhe ushqehet me kërna.
- GRIFSHË** f. 1. Zog më i madh se harabeli, me ngjyrë të murrme e me çafkë në kokë, që nxjerr një zë të çjerrë. Çafka e grifshës. Zëri i grifshës. Çirret si grifshë.
- GRIKËLL** f. Bregcë.
- GRILLË** f. Rosë e egër me trup më të vogël se pëllumbi, që rron në tufë.

- GRIZHËL** f. Laraskë.
- GRIZHLEMZË** f. Grifshë.
- GRYKAKUQ** m. Gushëkuq.
- GRYKALARMË** m. Zog këngëtar i ngjashëm me gushëkuqin, që e ka gushën të larme.
- GUACË** f. Gocë deti.
- GUASKË** f. butak që rron i mbështjellë me një mbulesë të tillë.
- GUGASH** I m. 1. Guhak.
- GUGASHE** f. Fem. e GUGASH, ~I I.
- GUGUÇE** f. 1. Kumri.
- GUHAK** m. 1. Lloj pëllumbi i egër e shtegtar, me trup të mbuluar me pendë ngjyrë hiri në të kaltër dhe me krahë të larmë.
2. fig. Njeri i hutuar dhe i pavëmendshëm; njeri i trashë nga mendja.
- GUMANË** f. Grerëz e madhe që nxjerr një zhurmë shurdhuese kur fluturon.
- GUR** m. Peshk guri shih te PESHK, ~U.
- GURNEC** m. Skort i bardhë.
- GURNECKË** f. Skort i bardhë, gurnec.
- GUSHAR** m. Gushëkuq.
- GUSHËBARDHË** m. Zog i murrme me gushë të bardhë, i ngjashëm me trumcakun, që shihet shpesh në dimër mbi dëborë.
- GUSHËKUQ** m. Zog i vogël këngëtar i ngjashëm me trumcakun, me trup të murrme e me gushë të kuqërreme.
- GUSHTAK** m. Cumri, qefulli i verës.
- GJAKFTOHTË** mb.
3. Që ka gjak të ftohtë, që i ndryshon temperatura e trupit sipas mjedisit ku jeton. Kafshë gjakftohtë.
- GJAKPIRËS** II m. Kafshë a kandërr që ushqehet duke thithur gjak.
- GJAKPIRËS** II mb. Që ushqehet duke thithur gjak. Kafshë gjakpirëse. Insekt gjakpirës.
- GJALLË** mb. Qime e gjallë shih te QIM/E, ~JA.
- GJANËS** f. Peshk me trup të gjatë e të shtypur, me kurriz në ngjyrë të trëndafiltë e me anët si të argjendta.
- GJARPËR** m. 1. Zvarranik pa këmbë, me trup të gjatë, të lakueshëm e dredhues, me lëkurë me luspa, që ka dhëmbë me helm ose që i mbështillet gjahut rrethëqark dhe e shtrëngon. Gjarpër i madh (i gjatë). Gjarpër helmues. Gjarpër i verbër. Gjarpër me pika. Gjarpër uji (deti). Gjarpër guri. Gjarpër me syze (me gjyzlykë) kobra. Gjarpër me zile gjarpër helmues, që ka në fund të bishtit një hapësirë konike, me të cilën bën një zhurmë tingëlluese. Lëkurë gjarpri. Helmi i gjarpri. E pickoi (e kafshoi, e hëngri) gjarpri. E zuri gjarpri. Përdridhet (rreshqet) si gjarpër.
- GJASHTËKËMBËSH** m. Kandërr me gjashtë këmbë ose me tre çifte këmbësh.
- GJEL** m. 1. Mashkulli i pulës, këndes. Gjel fushe. Lafsha e gjelit. Mish gjeli. Këndon gjeli. Fryhet si gjel.
- GJEL** DETI Mashkulli i pulës së detit; gjeldet, misërok.
- GJEL** I EGËR Shpend i madh i ngjashëm me këndesin, me pendë të zeza, me zë të çjerrë, që rron nëpër pyje; gjelegër.
- GJEL** UJËS Shpend i egër me trup të madh, me qafë të gjatë, me pendë si të murrme, që rron nëpër ujëra.
- GJELAC** m. 1. Shpend i egër me pendë të zeza, të kuqe e të bardha, që jeton buzë ujërave.
2. krahin. Qukapik.
- GJELAMAN** m. Flutur me trup në ngjyrë të gjelbër të errët e me vija të verdha, me krahë të mëdhenj e të zgjatur si bisht dallëndysheje, që dëmton gjethet e pemëve frutore.
- GJELAZEZ** m. Shpend i egër me trup të gjatë, me pendë të zeza, që ushqehet me peshq.

- GJELBËRUSHE** f. Zog pak më i madh se trumcaku, me pupla të gjelbra në të verdheme, që nuk shtegton.
- GJELDET** m. Gjel deti. Mish gjeldeti.
- GJELDETËS** m. Gjel deti.
- GJELE** f. Gjelëz.
- GJELEGËR** m. Gjel i egër.
- GJELËZ** f. Shpend i egër uji sa një pëllumb, me sqep të gjatë e të verdhë, me pendë të zeza e me majat e krahëve të bardha.
- GJELUJËS** m. Gjel ujës.
- GJEMB** m. Flutura e gjembave lloj fluture dëmtuese, vemjet e së cilës janë të përhimëta, me dy vija anësore të verdha dhe me gjemba të verdhë ose kafe. Lule gjembi bot. shih te LUL/E,~JA.
- GJEMBAÇ** m.
4. krahin. Iriq.
- GJER** m. Brejtës i vogël pylli, me qime të dendura e të buta në ngjyrë të përhimë, me bisht të gjatë e si furçë, që e kalon dimrin në gjumë. Strofka e gjerit. Lëkura e gjerit.
- GJERAK** m. Mashkulli i gjeraqinës, petrit.
- GJERAQINË** f. 1. Shpend i madh grabitqar, me pendë të larme, me krahë të gjatë dhe me kthetra; petrit.
- GJERORE** f. Femra e gjerit.
- GJETULL** f. Shigjetull.
- GJETHENGRËNËS** mb. 1. Që ha gjethet, që ushqehet me gjethet e bimëve. Krimb (brumbull) gjethengrënës. Vemje gjethengrënëse.
2. Përd. em. sipas kuptimit të mbiemrit. Gjethengrënësi i qepës.
- GJILPËRËZ** f.
2. Peshk deti me trup të hollë e të gjatë si ngjalë, bistër.
- GJINATORE** f. Kandërr e ngjashme me arëzën, me ngjyrë të verdhë, me këmbë të gjata, e cila mbledh deltinën në lëmshe të vegjël.
- GJINKALLË** f. 1. Kandërr me ngjyrë të murrme, me kokë të gjerë e të shtypur, me sy të dalë e me krahë të mëdhenj e të tejdukshëm, që lëshon në vapë një zë të zgjatur e gumëzhitës; cinxër. Zëri i gjinkallës. Kënga e gjinkallës. Këndon gjinkalla.
- GJINOKUQ** m. Gushëkuq.
- GJINOR** Kafshë e një gjinie me një tjetër, secila nga kafshët e një gjinie. Dallohet nga gjinori i vet.
- GJIRAFË** f. Kafshë gjitare përtypëse dythundrake, me trup të madh, me qafë e me këmbë shumë të gjata, me qime të verdha në të kuqe e me njolla të mëdha të murrme, që jeton në Afrikë. Qafa e gjirafës.
- GJITAR** m. 1. kryes. Kafshët kërbishtore më të larta, që kanë gjak të kuq e të ngrohtë, mushkëri për të marrë frymë etj. dhe që bëjnë të vegjël, të cilët i ushqen femra me qumështin e vet; sisor. Gjitar i ulët (i lartë). Gjitar ripërtypës. Klasa e gjitarëve.
2. Përd. mb. sipas kuptimit të emrit. Kafshë gjitare.
3. si mb. f. ~E. Që ka gjinj të mëdhenj dhe që jep shumë qumësht; qumështore. Lopë gjitare. Dhi gjitare.
- GJON** m. Shpend grabitqar me pendë të murrme, pak më i vogël se kukuvaajka, që këndon natën në verë, qokth. Zëri i gjonit. Këndon gjoni.
- GJONTH** m. Morri i pemëve. Gjethe me gjontha.
- GJUHÇË** f. Peshk i vogël i ujërave të ëmbla, me mish të shijshëm, që zakonisht përdoret i tymosur ose i konservuar. Gjuhca me vaj. Një kuti gjuhca.
- GJUHËZ** f.
6. Peshk i ujërave të kripura me trup petashuq si gjuhë, me të dy sytë në njërin anë, me ngjyrë të murrme, me mish të shijshëm e pa hala; shojzë deti. Gjuhëza e detit.
- GJYSMAMI** m. 1. Cinxami, çerr, ferrak.
2. Lakuriqësi i natës.

GJYSMAZOG m. Cinxami, çerr, ferrak.

GJYSMËFLATRORE m. vet. Rend kandrash me dy palë krahë, prej të cilëve, zakonisht, dy të përparmit janë të brritë.

HAMBAR m. Flutura e hambarëve shih te FLUTUR~A 1. Tenja e hambarëve shih tek TENJ/Ë,~A 1.

HARABEL m. 1. Zog i vogël, me pendët e kokës e të shpinës ngjyrëkafe dhe ato të pjesës së poshtme ngjyrëhiri, me sqep të madh e me këmbë të shkurtra, që jeton në tufë zakonisht pranë qendrave të banuara dhe që ushqehet kryesisht me drithë; trumcak. Harabeli i shtëpive. Harabel misri. Tufë harabelash. Si sqep harabeli.

HARDHI f. bot. Tenja e hardhisë. Pleshti i hardhisë. Merimanga e hardhisë. Zhuzhaku i hardhisë. Turigjati (hundëgjati) i hardhisë. Këpusha e hardhisë. Hiri i hardhisë. Vrug u i hardhisë.

HARDHJE f. 1. Zvarranik i vogël, me trup të zgjatur e në ngjyrë të murrme, me katër këmbë të shkurtra dhe me bisht të gjatë. Hardhja e mureve (e gardheve). E shkathët si hardhja. Ngjitet si hardhje.

HARENGË f. Peshk deti i vogël, me trup të shtypur, që jeton në tufa dhe hahet i freskët, i kripur ose i thatë. Harenga të kripura. Gjuetia e harengave.

HARRJE If. Kandërr shumë e vogël, me krahë të bardhë e të tejdukshëm, që del zakonisht në kohë të vapës, fluturon tufa-tufa duke lëshuar një zë të hollë, që hyn në sy a në vesh ose të pickon lëkurën. Iu ngjiten harrjet. Na hëngrën (na grinë) harrjet.

HERËKEQE f. Kukuvačkë. Po këndon herëkeqja.

HËNËZ f.

2. edhe ~A, ~AT Peshk i madh me trup të shtypur e me bark të bardhë, që jeton zakonisht në thellësi të detit dhe ushqehet me peshq të tjerë të vegjël.

HIBRID m. bot., Bimë a kafshë me tipare të veçanta, që del nga kryqëzimi i dy llojeve a i dy racave të afërta. Hibrid i dyfishtë. Hibrid misri. Hibrid duhani. Hibridi i plepit. Hibridet e pulave. Farishtja e hibrideve. Mushka është hibrid.

HIBRID mb. bot., Që ka dalë nga kryqëzimi i dy llojeve a i dy racave të afërta (për bimët e kafshët).

Bimë hibride. Misër hibrid. Duhan hibrid. Kafshë hibride. Pula hibride. Farë hibride. Fidan hibrid.

HIBRIDIZOJ kal., bot., Kryqëzoj dy lloje ose dy raca të afërta bimësh a kafshësh për të nxjerrë një lloj a një racë me veti e tipare të reja. Hibridizoj misrin (duhanin). Hibridizoj kafshët (bagëtitë).

HIBRIDIZUAR mb. bot., Që është nxjerrë nga kryqëzimi i dy llojeve a i dy racave të afërta, që është nxjerrë me anë të hibridizimit. Bimë (kafshë) e hibridizuar. Farë e hibridizuar.

HIDËR f. 1. Kafshë shumë e vogël, pa shtyllë kurrizore, me trupin si qese e zgjatur, që ka në njërin anë gojën me disa fije të holla e të përkulshme dhe që jeton në ujëra të qeta të lumenjve ose nëpër pellgje. Hidra e ujit të ëmbël.

HIENË f. 1. Kafshë e egër gjitare, mishn-grënëse e grabitqare, me trup sa të ujkut, me qimet ngjyrë hiri a të kuqërreme, që rron në vendet e shkreta të Azisë e të Afrikës dhe që ushqehet zakonisht me kërmë. Hiena laramane. Britma e hienës.

HIPOPOTAM m. 1. Kafshë e egër gjitare, barngrënëse, me trup të madh e të rëndë me kokë katërkëndëshe e me gojë të gjerë, me këmbë të shkurtra, me lëkurë shumë të trashë, pa qime e të zeshkët, që rron në Afrikë nëpër lumenj, liqene e moçale. Gjuetia e hipopotameve.

HIRTË mb. Krimbi i hirtë. Miu i hirtë.

HITHËR f. HITHËR DETI Kandil deti.

- HUNDËBRI** m. 1. Rinoqeront. Hundëbriri afrikan. Hundëbriri indian.
2. Një lloj brumbulli i madh, me ngjyrë të murrme, që ka në kokë një bri.
- HUNDËGJATË** m. Kandërr brejtëse si buburrec, me turi të gjatë, që është në disa lloje dhe që dëmton bimë të ndryshme. Hundëgjati i panxharit. Hundëgjati i hardhisë. Hundëgjati i lakrës. Hundëgjati i jonxhës. Hundëgjati i pemëve. Hundëgjati i ullirit. Hundëgjati i grurit. Hundëgjati i lëvores.
- HUT** m. 1. Një lloj bufi, me kokë të madhe e të rrumbullakët, me sqep të shkurtër e të kthyer, që rron nëpër pyje dhe këndon natën sikur vajton. Huti me veshë buf me veshë. Zog huti. Kënga e hutit.
- HUTË** I f. 1. Femra e hutit. Zogu i hutës. Ra huta në pula.
2. Shpend grabitqar, me kokë dhe me gushë të mbuluar me pupla, me qafë të rrjepur, me kthetra të mëdha, të forta e pak të kthyera, që rron nëpër pyje. Huta e bardhë kali i qyqes. Hutë deti pulëbardhë.
- HUTËRROJË** I f. shih HUT/Ë, ~A 12.
- HUTIN** m. Hut. Hutini me veshë.
- IRIQ** m. 1. Kafshë e vogël gjitare, që e ka trupin të mbuluar nga sipër me gjemba të fortë dhe që mblidhet si top për t'u mbrojtur nga rreziku. Gjembat e iriqit. Mblidhet si iriq.
- Iriq deti kafshë e vogël deti pa bosht kurizor, me trup të rrumbullakët dhe me një guaskë gëlqerore të mbuluar me gjemba që lëvizin.
- JAGUAR** m. Kafshë gjitare e egër, e ngjashme me leopardin, që rron në Amerikë dhe që ushqehet me mish.
- JAK** m. Kafshë e madhe përtypëse, me brirë të mëdhenj e me lesh të gjatë, e ngjashme me buallin, që jeton në malet e larta të Azisë Qendrore dhe shërben kryesisht si kafshë barre.
- JARGAVEC** m. Kërmill pa guaskë, jargës, ligavec. Dolën jargavecët.
- JONXHË** f. bot. Hundëgjati i jonxhës.
- KABISHT** m. Gërshërez.
- KACABU** m. Lloj buburreci, me ngjyrë të zezë, që jeton zakonisht nëpër shtëpi ose në vende ku hidhen mbeturina ushqimesh; furratarja e zezë. Dolën kacabunjte.
- KACADRE** m. Kacabu i madh, me ngjyrë të gjelbër të errët, që e ka kokën të gjerë dhe me dy brirë të harkuar e të dhëmbëzuar nga brenda. Brirët e kacadrerit. Mustaqe kacadreri mustaqe të harkuara e të kthyera përpjetë.
- KACAGJEL** m. 1. Milingonë e madhe me ngjyrë të kuqe të errët, kaposh.
- KAÇAMILL** m. Lloj kërmilli, që jeton afër brigjeve të detit dhe që peshkatarët e përdorin zakonisht si karrem për të zënë peshk; kërmill uji, kërmill deti; kërmill.
- KAÇUBAN** mb.
2. si em. ~, ~I m. ~Ë, ~ËT Çafkëlore.
- KAÇUL** m.
3. Lauresha me kaçirubë, çafkëlore.
- KAKËZOGËZ** f. 1. Zvarranik i vogël si gjarpër, i padëmshëm, në ngjyrë të argjendtë, që ushqehet me krimba dhe del zakonisht pas shiut.
- KALANDËR** I f. 1. Lloj laureshe, me shpinë të përhime, me nga një njollë të zezë në të dyja anët e gushës, që e bën çerdhen në tokë. Fole kalandre.
2. Insekt me ngjyrë të ndritshme, që shumëzohet shpejt dhe dëmton drithërat (grurin, orizin etj.). Kalandra e grurit. Kalandra e orizit. Preket nga kalandra.
- KALË** m.
- KALI** I DETIT Peshk me turi të madh e të zgjatur, që ka flatra me thumba dhe gjendet në detin Adriatik, në Mesdhe etj.
- KALI** I QYQES Mjellbardhë.

- KALË SHTRIGASH** Karkalec i madh me këmbë të gjata, që e ndryshon ngjyrën sipas mjedisit ku jeton.
- KALLAMAR** m.
2. Butak deti i ngjashëm me sepjen, por me trup më të hollë e të zgjatur, që ka brenda një petëz të fortë e të tejdukshme në trajtë pende.
- KALLI** m. Krimbi i kallirit shih te KRIMB, ~I 2.
- KAMELEON** m. 1. Zvarranik i vendeve të ngrohta, i ngjashëm me hardhjen, që ndërron ngjyrën e lëkurës në përshtatje me ngjyrën e mjedisit ku ndodhet. Llojet e kameleonëve. Si një kameleon.
- KANAL** m.
* Miu i kanaleve (të zeza) shih te MI, ~U2.
- KANARINË** f. 1. Zog këngëtar sa trumcaku, me trup të bukur e të shkathët, me pupla në ngjyrë të verdhë të hapur, që mbahet në kafaz për zërin e tij të këndshëm.
- KANDIL DETI** Kafshë deti me trup në trajtë kërpudhe e të bardhë si pelte, që lëshon një lëng djegës.
- KANGUR** m. Gjitar barngrënës, që jeton në Australi, që i ka këmbët e prapme më të gjata se të përparmet dhe ecën me kërcime (femra e tij ka nën bark një trastë të gjerë, ku mban të vegjlit derisa të rriten e të ecin vetë). Trasta e kangurit. Kërcen si kangur.
- KANUSHË** f. Lejlek.
- KANJUSHË** f. shih KANUSH/Ë, ~A.
- KAPOSH** m.
3. Milingonë e madhe që e ka trupin në ngjyrë të kuqërreme, kacagjel.
- KAPROLL** m. Gjitar dythundrak i familjes së drerëve, me qime të kuqërreme, me brirë të vegjël e të degëzuar dhe me këmbë të holla e të shkathëta; mashkulli i sorkadhes.
- KAPROLLE** f. 1. Femra e kaprollit, sorkadhe.
- KARABULLAK** m. 1. Shpend i madh uji, me pendë të zeza e të shndritshme, me qafë të gjatë e me një xhufkë të murrme në kokë, që jeton nëpër kënetat ose gjatë bregdetit dhe ushqehet kryesisht me peshk. Karabullak i madh. Gjuetia e karabullakut. Zhytet (noton) si karabullak.
- KARAVIDHE** f. 1. Gaforre. Llojet e karavidheve. Këmbët e karavidhes. Ecën si karavidhja.
- KARKALEC** m. 1. Kandërr me trup të madh e me krahë zakonisht në ngjyrë si të gjelbër, me këmbë të gjata, që kërcen me shkathtësi e fluturon larg dhe që dëmton rëndë të lashtat. Karkalec i gjelbër. Karkalec i murrmë. Tufë (re) karkalecash. Shfarosja e karkalecave. Kërcen si karkalec.
2. Kafshë deti që i ngjet kësaj kandrre, që e ka trupin të mbuluar me luspa rrathërrathë në ngjyrë të gjakut dhe që ka mish të shijshëm. Karkaleca deti. Gjuaj karkaleca.
- KARTHPULË** f. Drokth, fshikartë.
- KARRABISHT** m. Gërshërëz.
- KASTOR** m. Gjitar i madh brejtës, me kokën si hinkë, me bisht të gjatë dhe me lëkurë të mbuluar me qime në ngjyrë të kuqërreme, që jeton në strofka të ndërtuara me degë e me baltë zakonisht buzë lumenjve; lëkurë e punuar e kësaj kafshe. Këpucë (pallto, çantë) kastori.
- KASTRIQ** m. Gjarpër i madh, i gjatë deri në një metër e gjysmë, me kokë të shtypur, që ka mbi shpinë tri shirita me ngjyra të ndryshme; soval.
- KATRAVESH** m. 1. Kandërr e madhe fluturake, në ngjyrë të zezë, që ka katër antena të forta si brirë e që e bën folenë nëpër trungjet e kalbura ose në zgavra të drurëve. Brirët e katraveshit.
- KAVALL** m. Peshk kavall shih te PESHK, ~U.

KETËR m. Gjitar brejtës me trup të vogël e të shkathët, të mbuluar me qime të murrme, me bisht të gjatë si të dhelpres e me këmbët e përparme më të shkurtra se ato të prapmet, që kërcen e ngjitet me shpejtësi nëpër drurë dhe ushqehet me lende, me arra etj. Lëkurë ketri. Ngjitet si ketër.

KËLYSH DHEU Dosëza.

KËMBËKUQ mb.

2. si em. ~E, ~JA f. ~E, ~ET Thëllëzë.

KËMBËNYJËTUAR m. vet. Grupi më i lartë i kandrrave dhe i kafshëve jokërbishtore, që trupin dhe gjymtyrët i kanë të ndarë në unaza të lëvizshme.

KËMBËSHUMËZ f. Dyzetkëmbësh.

KËNDES m. 1. Shpend shtëpiak, me një lëshë të kuqe mbi kokë, me pendë në ngjyra të ndryshme dhe me bisht të kthyer, mashkulli i pulës, gjel. Këndes i egër. gjel i egër. Kënga e këndesave. Këndon këndesi. Zihen këndesat. Theri këndesin. Ecën si këndes.

KËPUSHË f. 1. Parazit i vogël, në trajtën e një merimange e me katër palë këmbë, që u ngjitet në lëkurë bagëtime, qenve etj., u thith gjakun dhe u shkakton sëmundje ngjitëse; rriqër. Këpusha e zgjebes parazit shumë i vogël që shkakton sëmundjen e zgjebes. Këpusha e hardhisë parazit shumë i vogël me ngjyrë të verdhë të errët e me dy njolla të kuqe në pjesën e përparme të anës shpinore, që dëmton gjethet e hardhisë. Ka zënë këpusha. Iu ngjit si këpushë.

KËRBISHTOR mb. 1. Që ka shtyllë kurrizore; kurrizor, vertebror. Kafshë kërbishtore.

2. si em. ~, ~I m. ~Ë, ~ËT. Kafshë kërbishtore.

KËRMILL m. 1. Kafshë e vogël me trup të butë, pa skelet, të përjargur e zakonisht të mbuluar me një guaskë në trajtë spiraleje dhe me dy palë brirthe përpara, që jeton në toka me lagështirë, në pyje, vreshta, kopshte etj. dhe ushqehet me bar; kafshë e tillë pa guaskë,

që jeton edhe në banesat përdhese me lagështirë a në ujë, ligavec. Kërmill i zhveshur (lakuriq) kërmill pa guaskë, jargës. Kërmill uji (deti) lloj kërmilli i madh e pa guaskë, që jeton në det. Kërmilli i tokës (i vreshtave, i pyjeve, i kopshteve). Samari i kërmillit. Mbledh kërmij. Mblidhet si kërmill.

KËRP m. bot.

* KËRP DHEU Urith.

KËRPËZ f. Zog i vogël këngëtar, që rron nëpër ara dhe ushqehet zakonisht me fara këрпи.

KËRTHINGËL f. Piskë.

KËRRMI f. Një lloj krimbi, që bren orenditë prej druri, dyert, dritaret etj. sidomos natën; krimbi i drurit.

KËSULER m. Laureshë, çafkëlore.

KICIRIBË f. Zog këngëtar, me trup të vogël, me pendë të murrme në kurriz dhe të bardha në bark, me një kaçirubë mbi kokë e me sqep të kthyer, që rron zakonisht nëpër ligatina.

KLLINZË f. Zog me pendë të zeza në kurriz dhe me njolla të blerta në të verdha, me gushë e gjoks të bardhë, që rron zakonisht afër ujërave dhe e bën çerdhen nëpër gropa në tokë.

KOBËR f. Gjarpër i madh me helm të fortë, me lara në qafë, që jeton në vende të nxeha; gjarpri me syze.

KOBISHT m. Gërshërëz.

KOCË II f. Peshk deti me trup të gjerë e shpatuk, me një shenjë të verdhë si ar midis syve dhe me dhëmbë të fortë, që e ka mishin shumë të shijshëm.

KOJLIK m. Kllinzë.

KOJRRILË f. shih KRILL/Ë, ~A.

KOKËDHËNË m. Kryegjati, qefulli i vjeshtës.

KOKOSH m.

3. Milingonë e madhe në ngjyrë të kuqe të errët, kacagjel.

KOLIBËR m. Shpend shumë i vogël, me pendë të bukura shumëngjyrëshe, që, kur fluturon, i lëviz krahët aq shpejt, sa nuk i duken (rron kryesisht në Amerikën e Jugut).

KORAL m. 1. zakon. Kafshë shumëqelizore të palëvizshme, që bëjnë pjesë në grupin e polipeve të fortë dhe që jetojnë së bashku në det ngjitur nëpër shkrepë.

2. Lëndë gëlqerore e formuar nga skeletet e këtyre kafshëve si kërcell i degëzuar në fund të detit, me ngjyrë të kuqe, të trëndafiltë a të bardhë, nga e cila bëhen stoli të ndryshme; stoli prej kësaj lënde. Korali i kuq (i bardhë). Korali natyror (artificial).

Rruaza (gjerdan) prej korali.

KORAN m. Peshk i llojit të troftës, me pika të kuqe në trup, që jeton në ujëra të ëmbla

KORB m. 1. Zog me trup të madh, me pendë të zeza ose si të përhimë, me krahë të gjerë, që e bën folenë nëpër drurë zakonisht në vende të vetmuara dhe ushqehet me kërmë. Pendët e korbit. Zogjtë e korbit. Krakëllima e korbave.

2. Peshk i llojit të qefullit, që jeton në ujëra të kripura, me trup të madh e të zgjatur në ngjyrë të errët dhe me kokë të zezë, që ka mish të majmë, të shijshëm e me pak hala.

4. përd. mb. I zi, i zi sterrë. I ka vetullat (qimet) korb.

5. përd. ndajf. Shumë (për ngjyrën e zezë). Me vetulla korb të zeza. I ka sytë (flokët) korb të zezë. Është bërë qielli korb i zi.

Korb sqep kuq shpend që rron në male, me trup rreth një gjysmë metri të gjatë, me sqep të verdhë dhe me këmbë të kuqe. Korb uji shpend uji më i madh se karabullaku, që e përdorin peshkatarët për të gjuajtur qefullin.

KORCULLESHË f. Cumri, qefulli i verës pasi ka lëshuar vezët.

KORROBACE f. 1. Gjuhëz; cironkë.

2. Peshk i vogël (edhe fig.). Sa një korrobace.

KOSHËZ f. Krimb i trashë, i cili u del gjatë dimrit nën lëkurë bagëtime të dobëta, sidomos lopëve e dhive.

KRAHATHADËR f. Zog grabitqar si skifteri, me sqep të kthyer, me kthetra të forta dhe me krahë si thadër, që i përdor për të vlarë zogj më të vegjël, duke i goditur me forcë.

KRAHATHATË f. Krahathadër.

KRAHËGJATË m. Zog më i madh se harabeli, që këndon bukur dhe mund të qëndrojë pezull në ajër për një kohë të gjatë me krahë të hapur. Këndon krahëgjatë.

KRAP m. 1. Peshk i madh i ujërave të ëmbla, me trup të mbuluar me luspa në ngjyrë ari të errët dhe me katër fije si mustaqe të gjata në turi, që e ka mishin me mjaft hala. Krap i madh (i vogël). Krap gungaç. Kokë krap. Tavë me krap.

KRAPULIQ m. 1. I vogli i krapit.

2. Peshk i familjes së krapit, që rron në ujëra të ëmbla, me trup të vogël e me një palë fije të gjata si mustaqe në nofullat e sipërme.

KREDHARAK m. 1. Shpend uji, me pjesën e sipërme të trupit në ngjyrë të murrme në të zezë dhe me gushën e barkun të bardhë, që ushqehet me peshq, të cilët i kap duke u kredhur në ujë.

KRI f. Kandërr e vogël dhe e zezë që bren drurin e orenditë, krimbi i drurit.

KRIMB m. 1. Kafshë e vogël pa skelet, me trup të zgjatur, të rrumbullakët, unazor e të butë, pa këmbë, që zvarritet me gjithë trupin e tij dhe që rron në tokë, në pleh, në gurë etj. Krimb i vogël (i hollë). Krimbi i dheut (i tokës). Krimb shiu. Zë peshk me krimba. Zogjtë hanë krimba. E shtypi si një krimb.

KRIMBALESH m. 1. Krimb i vogël, i mbuluar me një push të hollë si lesh, që dëmton gjethet e pemëve; vemje.

2. Larva e disa insekteve.

- KRIPTH** m. 1. Tokë e kripur jopjellore, kripërishtë. Edhe kripthet janë bërë toka buke.
3. Qime e gjallë.
- KROKODIL** m. 1. Rrëshqanor i madh, me trup deri gjashtë metra të gjatë e të mbuluar me një lëkurë të fortë, me kokë të shtypur, me gojë të madhe e me dhëmbë të fortë, që rron në ujërat e vendeve tropikale. Lëkurë krokodili. E hëngri krokodili.
- KRYEGJATË** m. Lloj qefulli me kokë të gjatë; qefulli i vjeshtës, kokëdhëni.
- KRYEHOLLË** m. Kryegjati.
- KRYEKUQ** m. Kryeartëz.
- KRYEMADH** m. Peshk i vogël grabitqar, me kokë të madhe e me trup rreth një pëlëmbë të gjatë, me ngjyrë të murrme e me njolla të çelëta, që rron zakonisht afër brigjeve të detit.
- KUBËL** f. Peshk me trup të gjatë rreth dy pëlëmbë, në ngjyrë hiri të errët, me njolla të zeza në të dy anët, që e ka mishin me shumë hala të holla dhe që rron në det e në ujëra të ëmbla, ku lëshon edhe vezët.
- KUKUMJACKË** f. Kukuvačkë. Zëri i kukumjačkës.
- KUKUVAJKË** f. Zog grabitqar, me kokë të gjerë dhe pak si të shtypur, me sy të verdhë e të rrumbullakët, me sqep të thyer, më bisht të gjatë në ngjyrë hiri e me njolla të bardha, që del natën, ushqehet me zogj e me minj dhe këndon me një zë; sikur vajton. Zëri i kukuvačkës. Është si kukuvačkë është e shëmtuar (zakonisht për grat).
- KUMIHARK** m. Pilivesë.
- KUMRI** f. Lloj pëllumbi me pendë e pupla në ngjyrë të kuqe të çelur, të përzier me të verdhë e të bardhë dhe me një njollë të harkuar pas qafës. Këndon kumria.
- KUNADHE** f. Shqarth. Kunadhe e bardhë. Lëkurë kunadhe. Jakë prej kunadheje. I hëngri pulat kunadhja.
- KUNEL** m. 1. Lepur i butë. Kunel i bardhë.
2. Lepur i vogël, lepurush; pegun.
- KUNUP** m. Mushkonjë.
- KUQ** mb. Krimbi i kuq. Morri i kuq. Merimanga e kuqe. Tenja e kuqe.
- KUQËL** II f. 1. Rosë e madhe kuqalashë.
- KURRILLË** f. Zog shtegtar, me trup të madh e me pendë të përhime, me këmbë të gjata e me qafë të gjatë si të lejlekut dhe me sqep të shkurtër. Tufë kurrillash. Fluturojnë (shtegtojnë) kurrillat.
- LAKEÇ** m. Krap i vogël, i paritur (më i madh se krapuliqi).
- LAKËR** f. Çimka (tartabiqja) e lakrës. Futura e lakrës.
Miza e lakrës. Morri i lakrës. Pleshti i lakrës. Tenja e lakrës. Turigjati i lakrës. Vemja e lakrës. Vrugu i lakrës.
- LAKËR DETI** bot. Lloj alge e ujërave të kripura që bëhet e rrumbullakët si kokë lakre.
- LAKËR PATE** bot. Bimë barishtore e egër, me gjethe si të dejzës, por më të vogla, me lule të verdha e me fara të grumbulluara në vile, që rritet në toka me lagështi dhe e hanë shumë patat e rosat.
- LAKËR QENI** bot. Bimë barishtore e egër, që rritet në kullota e në vende me shkurre dhe që ka lëng të hidhur e mund të helmojë kafshët që e hanë.
- LAKËR E VERDHË** bot. Bimë barishtore e egër, me lule të verdha e të rrumbullakëta, me gjethe të vogla e me push në anën e poshtme, që rritet në vende pa ujë ose pa lagështirë të tepërt.
- LAKËR ZOGU** bot. Bimë barishtore njëvjeçare, me gjethe të holla, me lule të grumbulluara dhe me fara të mbledhura si xhufkë, të cilat i hanë shumë zogjtë dhe që rritet në lëndina e fusha.
- LAKURIQ** m. 1. Lakuriqës. Lakuriqi i natës.

- LAKURIQËS** m. Gjitar i vogël sa një zog, i zi, me krahë të gjerë e të mbuluar me lëkurë të hollë, që i ngjan miut, fluturon natën dhe ushqehet me kandrra e me pemë të ndryshme; lakuriq, zogu i natës. Lakuriqës veshgjatë. Fole lakuriqësish.
- LALË** II m. bised.
* Nusja e lalës nuselalë.
- LAMË** f. Kafshë e viseve të Amerikës së Jugut, afërsisht sa një dhi e madhe, që ka lesh të mirë dhe që shërben si kafshë ngarkese.
- LAPURAK** m. 1. Lakuriqësi i natës.
- LARADASH** m. 1. Pelikan.
- LARAKUQE** f. Nuselalë.
- LARAMANE** f. 1. Lloj rose e egër, me trup të vogël e me pendë të larme, që rri nëpër liqene.
2. Pikëlore.
- LARASKË** f. 1. Shpend i ngjashëm me sorrën, me pendë të përhime e të bardha, me bisht të gjatë e me krahë të shkurtër, që rron në fusha, në pyje e në qendra të banuara; grizhël.
- LARASH** m. 1. Lloj fajkoi me trup të larmë, që ushqehet me këрма.
2. Lloj rose e egër me pendë të larme, që rri në det dhe që del nëpër brigje e kënetat vetëm në kohë të keqe e me stuhi. Larash deti.
- LARËZ** II f. 1. Zog i vogël sa një harabel, me trup të larmë, që rri më shumë livadheve.
2. Lloj peshku i vogël me lara në trup.
- LAROSH** m. shih LARASH, ~I 1.
- LARVË** f. Trajtë fillestare e kandrrave, e krimbave, e bretkosave dhe e disa kafshëve të ujit, që sapo ka dalë nga veza dhe jeton më vete; vemje. Larva kandrrash (mizash).
Larvat e krimbave (e fluturave, e bretkosave, e peshqve).
- LASHTA** f. vet.
* Shushunja e të lashtave (e drithërave) shih te SHUSHUNJ/Ë, ~A.
- LAURESHË** f. 1. Çafkëlore. Lauresha e malit. Kënga e laureshës.
- LEJLEK** m. 1. Shpend i madh shtegtar, me pendë të bardha, me qafë e me sqep të gjatë dhe me këmbë të gjata, që jeton në vende të ngrohta pranë brigjeve të liqeneve, të lumenjve ose nëpër moçalishte, e bën folenë zakonisht nëpër drurë të lartë dhe ushqehet sidomos me peshq, me bretkosa, me gjarpërinj, me krimba, me brejtës të vegjël etj.
2. Peshk deti me trup të zgjatur, me bark të bardhë, me shpinë të kaltërreme e me bisht të gjatë, të hollë e të mprehtë si sharrë.
- LEKËN** f. Femra e koranit. Lekna pikalore (me pika). Lekna e liqenit. Lekna e verës.
- LEOPARD** m. Kafshë grabitqare e familjes së maceve, e madhe sa tigri, me qime të verdhë e me lara të zeza, që është shumë e shpejtë e ngjitet me shkathtësi edhe mbi drurët dhe që rron në pyjet e Afrikës e të Azisë. Gjuetia e leopardit. Lëkurë leopardi.
- LEPUR** m. 1. Kafshë gjitare brejtëse, me kokë të rumbullakët e me veshë të gjatë, me trupin të mbuluar me qime të gjata në ngjyrë të murrme ose të bardhë, me këmbët e prapme më të gjata se të përparmet, që rend shumë shpejt dhe që njihet si frikacake. Lepur i egër. Lepur i butë. Lepur i bardhë. Lepuri i fushave. Lëkurë (lesh) lepuri. Bishti i lepurit. Mish lepuri. Gjurmë lepujsh. Vrau një lepur. Lepuri i madh rri në ferrë të vogël. fj. u.
- LEVREK** m. 1. Peshk i ujërave të kripura, më i madh se qefulli, me trupin në ngjyrë hiri të errët përsipër dhe të bardhë e të shndritshëm poshtë, me dy pendë në kurriz, i cili noton shpejt dhe ka mish shumë të shijshëm.
- LËKITËR** f. shih KETËR.
- LËKURËGJEMBORË** m. vet. Familje kafshësh jokërbishtore të ujërave të kripura,

si iriqi i detit, ylli i detit etj., që e kanë lëkurën me gjemba.

LËKURËTRASHË m. vet. Kafshë gjitare si hipopotami, rinoqeronti etj., që ka lëkurë të trashë, me qime të shkurtra e të forta dhe bark të madh.

LËVORENGRËNËS mb. libr.

2. si em. ~, ~I m. ~, ~IT Lloj zhuzhaku që ha lëvoren e drurëve a të pemëve.

LËVRIZË f. Krimb i gjatë me trup të shtypur, që jeton si parazit në zorrët e njerëzve; shirit.

LIKURISHTË f. Tetëkëmbësh.

LIS m.

Mizë lisi lloj mize e vogël, që u bie hardhive dhe i than krejt.

LIVADH m. Trumcaku i livadheve.

LOJBË f. Peshk deti, me trup vezak e të gjatë deri në dy metra, me ngjyrë të gjelbër ose të hirtë të çelur në kurriz e anash dhe të argjendtë në bark, me kokë të gjerë, me dy pendë të dhëmbëzuara e të forta në kurriz, që arrin deri në pesëdhjetë kilogramë e ka mish të shijshëm.

LOPATË f.

6. shih LOPATËZ, ~A 1. bised. Shuall i këmbës, shputë. Lopatat e këmbës.

LOPATËZ f. 1. Fulterëz. Lëvrijnë lopatëzat.

LOPË f. Lopë deti gjitar me trup shumë të madh, që ka jetuar në tufa kryesisht në Oqeanin e Ngrirë të Veriut dhe që tani është zhdukur.

LORËZ f. Shpend i vogël nate, me pendë ngjyrë kafe të çelur ose si të kuqe, me bisht të gjatë, që nxjerr një zë të përva-jshëm kur këndon. Këndon lorëza. Flet si lorëza flet shpejt e me zë të gjerrë.

LOSË f. Lloj peshku i ujërave të ëmbla i ngjashëm me troftën, por me trup më të shtypur dhe me pendën kurrizore në trajtën e freskores.

LUAN m. 1. Kafshë e egër gjitare, e madhe e mishngrënëse, me lesh të shkurtër e të verdhemë, me një tufë qimesh në fund të bishtit (dhe te mashkulli me një kreshtë a kurorë qimesh të gjata në qafë e rreth kokës), që ndodhet në disa vise të Afrikës, të Azisë etj. dhe që mbahet si kafsha më e fortë në përlëshje me të tjerat. Gjuetia e luanëve. I fortë si luan. Luftoi si luan.

LUANI I DETIT Lloj foke e madhe e me veshë, që jeton zakonisht në oqean.

LUBARDHË f. Kafshë e egër mishngrënëse e viseve malore, me qime të shndritshme, të bardha në të kuqërreme, që i ngjan luqerbullit dhe është shumë e shpejtë; lulëz.

LUGËS III m. Sqeplugë.

LUGVESHËZ f. Gërshërëz.

LULËZ II f. Lubardhë.

LUNDËR II f. Kafshë e egër e mishngrënëse, e madhe sa një mace, me lëkurë të butë e të çmueshme, me qime të shndritshme në ngjyrë kafe të mbyllur, që rron në ujëra të ëmbla dhe ushqehet me peshq; vidër. Lëkurë lundre.

LUNDËRZ f. Lundër, vidër.

LUQERBULL m. Rrëqebull. Lëkurë luqerbulli.

LLALLË I f. 1. Flutur, më e madhe se miza e zakonshme, e cila i bën vezët në zgjuan e bletëve dhe i detyron këto të largohen prej këtej. Llalla i prish bletët.

LLOÇË f. Kubël e vogël në moshën prej katër muajsh deri në një vit.

LLOGOBERE II f. Rosë e egër që e ka zënë vera pa shtegtuar.

LLOSKË f. Peshk i ujërave të ëmbla, i ngjashëm me krapin, por me trup më të shkurtër e më të shtypur anash; me kokë të vogël e me shumë hala; drangë.

Lloskat e Liqenit të Shkodrës.

- MACE** f. Mace e egër kafshë e egër mishn-grënëse, më e madhe se macja e butë, me qime ngjyrë hiri a ngjyrëkafe të hapët, që jeton në pyll dhe ushqehet zakonisht me minj etj.
- MACE** DETI Lloj peshku me erë të veçantë.
- MAJ** I m.
Zhuzhaku i majit shih te **ZHUZHAK**, ~U.
- MAJMUN** m. 1. Kafshë gjitare shumë e ngjashme me njeriun, që rron në pyjet tropikale dhe që dy këmbët e para i ka më të gjata e mund t'i përdorë si duar. Këlysh majmuni.
- MAKNORE** f. Shumëkëmbësh.
- MARSATORE** f. Rosë e egër shtegtare, që i ngjet kurrillës e që vjen në muajin mars.
- MEDUZË** f. 1. Kandil deti.
- MELCË** f. Kubël e vogël deri në moshën katër muajsh.
- MERIMANGË** f. 1. Kafshë me trup të vogël e me ngjyra të ndryshme, me katër këmbë të holla e të gjata, që rron nëpër vende të errëta (nëpër bodrume, në qoshet e dhomave etj.), ku end rrjeta të dendura prej fijesh shumë të holla. Merimanga e shtëpis ë(e bodrumeve). Pëlhura (cerga) e merimangës. Shtrati i merimangës. Ra miza në cergën e merimangës.
- MERIMANGORE** m. vet. Klasë e disa kafshëve të vogla jokërbishtore (si merimanga, akrepi, këpusha etj.), të cilat e kanë kokën të bashkuar me kraharorin.
- MËLLENJË** f. 1. Zog i vogël shtegtar nga rendi i harabelave, me pupla të zeza e të ndritshme, me sqep të verdhë si në ngjyrë portokalli e me këmbë të murrme, që rri zakonisht nëpër ferra e nëpër shkurre; mullizezë.
- MËLLIJAN** m. Mashkulli i mëllenjës.
- MËMËZ** f. 1. Matka e bletëve. Mëmëza e bletëve.
- MËRUNË** f. Skort i zi
- MI** m. Zog miu (zog ferre, zog shtrige) shih te **ZOG**, ~U.
- MICAK** m. Cinxami. Zuri një micak.
- MIDHJE** f. Butak i vogël në trajtën e bajames, i mbrojtur nga një guaskë gëlqerore prej dy kapakësh në ngjyrë të errët, që rron në koloni buzë brigjeve të deteve a të liqeneve, dhe që përdoret për ushqim. Midhje të fërguara. Midhje deti (liqeni). Gjellë me midhje.
- MILINGONË** f. Kandërr e vogël me ngjyrë të zezë, që rron me shumicë nëpër drurë, në fole të bëra në dhe etj.; mizë dheu, mizë përdhese, thnegël. Fole milingonash. E vogël sa një milingonë. Punon si milingonë. Lëvrijnë si milingonat.
- MISËR** m. Krimbi i misrit shih te **KRIMB**, ~I 2. Morri i misrit shih te **MORR**, ~I 2. Zhuzhaku i misrit shih te **ZHUZHAK**, ~U.
- MISKË** f. 1. Pulë deti, misëroke. Vezë miske.
- MISKËR** f. I vogli i cironkës.
- MISHNGRËNËS** m. Kafshë gjitare kryesisht e egër, që i ka dhëmbët e syrit shumë të mprehtë e dhëmballët të forta (si luani, tigri, ujku, qeni, macja etj.), ka kthetra dhe ushqehet me mish; vet. rendi i këtyre kafshëve. Rendi i mishngrënësve.
- MIZË** f. Zogu mizë shih te **ZOG**, ~U.
- MJELLBARDHË** f. Shpend shtegtar si huta, me pendë të bardha e me skajet e krahëve në ngjyrë të zezë, që vjen në vendin tonë në pranverë; huta e bardhë, kali i qyqes.
- MJELLMË** f. 1. Shpend i madh uji, me qafë të gjatë e të lakueshme, me krahë të gjerë, me pendë zakonisht të bardha e të shkëlqyeshme si bora, që shtegton. Mjellmë e bardhë. Mjellmë e butë. E bukur (e bardhë) si mjellmë. Pendët e mjellmës.
- MLYSH** m. 1. Peshk grabitqar i ujërave të ëmbla, me trup gjatosh dhe me turi të mprehtë e petashuq, që nuk e ka mishin të shijshëm. Mlysh i madh.
- MOKËRR** f. Shumëkëmbësh, dyzetkëmbësh.

- MOLË** f. 1. Kandërr me dy palë krahë, që gjatë jetës së saj zhvillohet nga veza në larvë, në krimb e më pas në flutur, e cila bren sendet e leshta, gëzofët, drithërat, bimë të ndryshme etj.; tenjë. Mola e grurit (e drithërave). Mola e dyllit. Mola e mollës. Mola e qepës. Bar mole. kim. naftalinë. E hëngri (e griu) mola qilimin (pallton).
- MOLËZ** f. Molë.
- MOLUSK** m. zakon. shih BUTAK, ~U. Molusqet e detit (e tokës). Klasa e molusqeve. Ushqehet me molusqe.
- MOLLË** f. Morri i mollës. Çimka e mollës.
- MOLLËKUQE** f. Kandërr e vogël, me trup në trajtë vezake dhe me dy palë krahë, nga të cilët dy të sipërmit janë të fortë, të kuq e kanë shtatë pika të zeza.
- MORR** m. 1. Kandërr e vogël pa krahë, që rron si parazit te njerëz të papastër (në trup, sidomos në kokë, në rrobat, në shtresa e mbulesa), te disa kafshë e shpendë etj. Morri i kuq
- MULLENJË** f. Mëllenjë.
- MULLIBARDHË** f. Lloj mëllenje me kurriz të murrmë si në ngjyrë të ullirit, me gushë dhe bark në të bardhë e me njolla të errëta, që këndon bukur e ka mish të shijshëm.
- MULLIUJËSE** f. Mëllenjë me ngjyrë të murrme e me sqep të gjatë, që rron anës lumenjve dhe ushqehet me peshq të vegjël; mullizezë uji, mëllenjë sqepgjati.
- MULLIZEZË** f. Mëllenja e zakonshme. Dimrit këndojnë mullizezat.
- MURGESHË** II f. 1. Flutur e madhe me shirita të zinj e njolla të zeza në krahë dhe në bark, vemja e së cilës njihet si dëmtues i drurëve e sidomos i pishave.
2. Kandërr fluturuese që e ndryshon ngjyrën sipas mjedisit, me trup shumë të gjatë, me kokën trekëndëshe e shumë të lëvizshme, me sy të dalë, me dy palë krahë të hollë, me të cilët, duke i fërkuar bën një zhurmë.
- MURRAK** m. Harabel.
- MURRASH** m. Harabel.
- MURRJELË** f. 1. Lloj zekthi, pak më i madh se zekthi i zakonshëm. E zuri murrjela. I hëngri (i pickoi) lopët murrjela. Lëviz si murrjelë s' rri në një vend, lëviz shpejt sa andej këtej. E gjeti si murrjela.
- MURRMË** mb. Krimbi i murrmë. Miu i murrmë. Ariu i murrmë. Bretkosa e murrme.
- MUSTAK** m. 1. kryes. Mustaqe.
2. Lloj krapit me trup të kuqërremtë, me nofullën e sipërme të dalë, me buzë të trasha e me katër qime si mustaqe, që rron nëpër lumenj me shtrat prej guri. Zë mustakë.
- MUSHICË** f. 1. zakon. Miza të vogla si harrije, që sillen me shumicë në vende me lagështirë e sidomos në vende ku punohet rrushi a ku ka bërsi. Mushica e bostaneve. Tufë mushicash. Sillen mushicat rreth llambës (rreth dritës).
- MUSHKONJË** f. Kandërr e vogël, me trup të hollë, me një palë krahë, me këmbë të gjata dhe me një thumb në turi, që rri zakonisht pranë pellgjeve e në vende moçalore dhe që të pickon, thith gjakun e mund të përhapë sëmundje të ndryshme. Mushkonja e zakonshme. Mushkonja e malaries anofele. Fole mushkonjash. Të grinin mushkonjat.
- NDALK** m. Peshk i vogël deti, që ka mbi kokë një organ me anën e të cilit u ngjitet peshqve të tjerë më të mëdhenj ose anijeve, që ta tërheqin pas vetes.
- NDËRLIKUAR** mb. Kafshët e ndërlikuara. kafshë që kanë arritur një fazë të lartë zhvillimi biologjik.
- NEPËRKË** f. 1. Gjarpër helmues, me kokën të shtypur në trajtë trekëndëshi, me trupin të mbuluar nga luspa me ngjyra të ndryshme, me dy dhëmbë në gojë dhe me bisht të shkurtër. Nepërkë e shkruar. Nepërkë pika-pika. Nepërkë shullëri. Helmi i nepërkës. Fishkëllima e nepërkës.

- NGJALË** f. 1. Peshk që rron në det dhe në ujëra të ëmbla, me trup të gjatë e të hollë si të gjarprit, pa luspa e me mish të shijshëm. Ngjalë lumi (liqeni). Ngjalë deti. Ngjalë balçe ngjalë që rron në llumishtat. Me trup si ngjalë me trup të hollë e të shkathët; meshollë.
- NIMFË** f.
2. Fazë e zhvillimit të larvave të disa insekteve, kur ato mbështillen me një cipë me fshikëz. Faza e nimfës. Shndërrohet (kthehet) në nimfë.
- NOR** m. Shpend uji shtegtar, i madh sa një pulë, me këmbë të shkurtra, që zhytet me shkathësi në ujë dhe është i shpejtë në fluturim. Nor i bardhë si bora.
- NOSIT** m. krahin. Pelikan.
- NUSE** f. Nusja e lalës Nuselala, bukla, nuse e djemve, nuse e mirë, nuse e bukur. Nuse pashke Mollëkuqe.
- NUSEBUKUR** f. Nuselalë.
- NUSELALË** f. Kafshë gjitare mishngrënëse sa një mace, me trup të shkathët, me gëzof të murrme a të kuqërremtë sipër e të bardhë në bark; bukël, nusël, nusëz. E shkathët si nuselalë.
- NUSËL** f. Nuselalë, bukël.
- NUSËZ** f. Nuselalë.
- NJËTHUNDRAK** mb. 1. Që ka në secilën këmbë vetëm një thundër (për kafshët). Kafshë njëthundrake kali, gomari etj.
2. si em. ~, ~U m. zakon. ~Ë, ~ËT. Familje kafshësh, ku hyjnë kali, gomari, mushka e zebra, që kanë në secilën këmbë vetëm një thundër. Rritja e njëthundrakëve. Shtimi i njëthundrakëve.
- NJILË** f. Lloj peshku i ujërave të ëmbla, i ngjashëm me krapin e me kokë të mprehtë si të ngjalës, me kurriz të murrme, me bark të bardhë e me pika, që e ka mishin të shijshëm, por me shumë hala. Njila liqeni (lumi).
- OKLONJË** f. Kërmill deti.
- OKTAPOD** m. 1. Tetë këmbësh, likurishtë. Këmbët (koka) e oktapodit.
- ORANGUTANG** m. Majmun trupmadh pa bisht, me krahë të gjatë, që rron në pyjet e ishujve Sumatra e Borneo.
- PALLUA** m. Shpend i madh sa një pulë deti, me një xhufkë në kokë, me pendë shumëngjyrëse e të ndritshme, shumë të gjata në bisht, të cilin e hap si erashkë. Femra e palloit. Bishti i palloit. Pendë palloi.
- PANTERË** f. Kafshë gjitare e egër, mishngrënëse, me trup të madh e me lëkurë të verdhë me njolla të zeza. Pantera e zezë. Lëkurë pantere. Iu hodh si panterë.
- PANXHAR** m. bot. Breshkëza e panxharit.
- PAPAGALL** m. 1. Zog i vendeve të nxehta me sqep të verdhë, të gjatë e të kthyer nga poshtë, me pupla shumëngjyrëse, që ka aftësi të shqiptojë fjalë duke imituar njeriun. Papagall i gjelbër (i kuq). Pendë papagalli. Zë papagalli. Mëson si papagall mëson përmendësh, në mënyrë mekanike. E përsërit si papagall.
- PASTËR** f. Pastër deti yll deti.
- PATATE** f. bot. Buburreci (vrugu) i patates.
- PATË** f. Shpend më i madh se rosa, me qafë të gjatë, me sqep të madh, të rrafshët e të verdhë, me këmbë në trajtë të pëllëmbës, që mbahet si shpend shtëpiak ose që rron si shpend i egër në vende me ujë. Patë e bardhë (e murrme). Patat e egra. Patë e pjekur (e skuqur). Patë deti. Tufë patash. Ruajtësi i patave. Mish (dhjamë, pendë, vezë) pate. Mban (rrit) pata. Është (ecën) si patë është i ngjallur e mezi lëviz a mezi ecën, ecën duke u tundur sa andej këtej.
- PATOK** m. 1. Mashkulli i patës. Pendët e patokut. Me qafë si të patokut.
- PELIGORGË** f. Bregcë.
- PENDËKUQ** m. Një lloj krapin.

PESHK m. 1. Kafshë kurrizore e ujërave të ëmbla e të kripura, me trup shpatuk e të zgjatur si bosht, zakonisht të mbuluar me luspa, me pendë të forta anash e mbi shpinë, që merr frymë me anë të verzave. Peshk i madh (i vogël). Peshk i kuq. Peshk i njomë (i thatë, i kripur, i tymosur). Peshk i zier (i pjekur, i skuqur). Peshk deti (lumi, liqeni). Peshk me hala (pa hala). Halë peshku. Vezët e peshkut. Zë (gjuaj) peshk me grep (me rrjetë). Noton (rrëshqet) si peshk.

Peshk elektrik Peshk deti me trup të rumbullakët, të sheshtë she me bisht, i pajisur me organe të posaçme që lëshojnë ngarkesa elektrike. Peshk fluturak peshk fluturues. Peshk fluturues peshk deti me dy pendët çifte të gjoksit si krahë, me të cilat fluturon ulët mbi sipërfaqen e ujit në një larësi rreth dyqind metrash. Peshk guri peshk i vogël deti, zakonisht me kurriz të murrmë, që jeton në thellësi, zakonisht nën gurë re shkëmbinj e nuk ha het. Peshk pëllumb peshk deti grabitqar, i familjes së peshkaqenëve, pa brinjë kër-core.

PESHKAQEN m. 1. Peshk deti grabitqar, me trup të madh, të fuqishëm e të mbuluar me lëkurë të ashpër, me gojë të lakuar si hark në pjesën e poshtme dhe me dhëmbë të fortë e të mprehtë. Peshkaqeni i bardhë. Mish (dhjamë) peshkaqeni. E hëngrën peshkaqenët.

PESHK-KAVALL m.

Peshk me trup të zgjatur si të ngjalës, me turi të rumbullakët. Që ka pesë deri shtatë vrime në të dy anët e trupit fill pas kokës.

PESHK-SHARRË m.

Peshk deti që ka përpara një zgjatim të pajisur anash me dhëmbëza si sharrë.

PESHK-SHIGJETË m.

Peshk deti me trup të zgjatur si bosht dhe me turi të hollë, që noton drejt si shigjetë.

PESHK-SHIRIT m.

Peshk deti me trup të zgjatur e të hollë dhe me ngjyrë të kuqërremtë.

PESHK-SHPATË m.

Peshk deti, me trup të ndritshëm, petak e të gjatë deri në katër metra dhe me turi të mprehta si shpatë. Peshku-shpatë çan edhe anijen.

PESHKTH m. 1. zvol. e PESH/K,~ KU.

PETRIT m. 1. Shpend grabitqar i ngjashëm me skifterin, me kurrizin të murrmë a të hirtë, me barkun të bardhë e me këmbët të verdha, që ka sqep të kthyer dhe thonj e krahë të fuqishëm; sokol. I shpejtë si petrit.

PËLLUMB m. 1. Shpend i butë a i egër me krahë të shkurtër, me pendë të bardha ose ngjyrë hiri në të kaltër, me gushë pak të dalë dhe me pupla në këmbë, që mund të bëjë fluturime të gjata dhe që mbahet si simbol i butësisë, i pastërtisë, i bukurisë dhe i paqes. Pëllumb i butë. Pëllumb i egër. Pëllumb poste. Çift pëllumbash. Gugatje pëllumbash. Kafaz pëllumbash. Mish pëllumbi. Vezë pëllumbi. Gjuetia e pëllumbave.

* Peshk pëllumb shih te PESHK,~U.

PËRÇOLLAK m. Akrep, sfurk.

PËRDHES mb.

* Mizë përdhese milingonë, mizë dheu.

PËRHERSHËM mb. Shpendë të përherëshëm shpendë që qëndrojnë në një vend gjatë gjithë vitit; kund. shpendë shtegtarë.

PËRTYPËS mb.

2. shih RIPËRTYPËS,~E. Kafshë përtypëse.

PICËRRAK m.

2. Zvarranik i ngjashëm me hardhucën, por më i madh se ajo, me pika të verdha në trup, që del zakonisht në pranverë pas shiut; pikëlore, salamandër.

PICKATË f. 1. Mushicë.

PIKËLORE f. Picërrak, salamandër.

PIKTH m. Qukapik.

- PILIVESË** f. 1. Kandërr me trup të hollë, me krahë të gjatë, të tejdukshëm e me deje, që i lëshon larvat në vende me lagështirë.
- PINGUIN** m. Shpend uji kryesisht i viseve të Antarktikut, me trup të madh e me bisht të shkurtër, me krimbë si pëllëmbë e me krahë të pazhvilluar, që nuk fluturon, por zhytet në ujë e noton mirë. Ecën si pinguin ecën duke i hedhur këmbët anash e duke u tundur.
- PISËRËNGË** f. Pikëlore, salamandër.
- PISKË** f. 1. Shpend shtegtar që rron nëpër ujëra, me trup sa një laraskë, me pendë të larme, me kokë të madhe, me qafë të shkurtër e me një kaçulitë mbi krye; kërtëhingël. Klithmat e piskave.
2. shih PISK,~U.
- PITON** m. Gjarpër i madh e pa helm i viseve tropikale, me trup të gjatë deri në dhjetë metra. Pitoni gëlltiti një dash të tërë.
- PJESHKË** f. Krimbi i pjeshkës. Vemja e pjeshkës. Morri i pjeshkës.
- PLANOS** m. 1. Beng, fikës.
2. Shpend i vogël (turtull, thëllëzë etj.), që e vënë në kafaz për të ndjellë e për të kapur shpendë të tjerë.
- PLESHT** m. 1. Parazit i njeriut e i kafshëve, me trup shumë të vogël e në ngjyrë kafe të errët, që kërcen shumë, pickon e thith gjak. Pleshtat e dhive (e qenve, e shpendëve, e maces). Bar pleshtash. Sa një plesht shumë i vogël. Kishte zënë pleshta. Kërcen si plesht.
2. Pjesë e parë e emërtimeve të pathjeshta për disa lloje kandrrash të vogla, me madhësi dhe ngjyra të ndryshme, që dëmtojnë zakonisht gjethet e perimeve, të pemëve etj. Pleshti i gjelbër kandërr e vogël me ngjyrë të gjelbër në të verdhë, që bren e dëmton zakonisht trangujt, jonxhën etj. Pleshti i bletës morri i bletës. Pleshti i drithërave. Pleshti i hardhisë (i mollës). Pleshti i panxharit (i lakrës, i patates). Plesht rëre kandërr si pleshti i zakonshëm, por që nuk kërcen. Pleshti i tokës kandërr si pleshti i zakonshëm, me trup vezak e ngjyrë hiri, që dimëron në të çarat e tokës, në gjethet e thata etj. dhe që dëmton gjethet e lakrës, të rrepës, të panxharit të sheqerit etj.
Plesht uji (deti) gaforre e vogël, që jeton në ujëra të ëmbla e lëviz duke kërcyer.
- PLLASHICË** f. krahin. Cironkë; gjuhëz.
- PORTOKALL** m. Miza e portokajve.
- PRAPMË** mb. Gjymtyrët (këmbët) e prapme. Rrotat e prapme të makinës. Rreshti i prapmë.
- PREKËL** f. 1. Bbirth, antenë.
- PRERËS** mb. Dhëmbët prerës. Punime prerëse (në miniera ku priten shtresat e mineralit).
- PUÇIBABË** f. Lloj karkaleci me këmbë të gjata e pa krahë.
- PULEGËR** f. Pulë e egër.
- PULË** f. 1. Shpend shtëpiak, me trup të vogël e me krahë të shkurtër, që mbahet për vezët dhe për mishin; femra e gjelit; m. tërësia e këtyre shpendëve (meshkuj e femra). Pulë e bardhë (e zezë). Pulë e majme. Pulë pikaloshe. Pulë këmbëleshe. Pulë shqerake (fushe) pula e zakonshme. Pulë e pjekur. Pulat e kooperativës. Mish (vezë) pule. Koteci i pulave. Ndjell pulat. Theri një pulë. E vuri pulën kllaçkë. Ra dhelpra në pula.
2. Kokërr misri e pjekur, por që nuk ka plasur ose nuk është bërë pupagjel. Misri mbeti pulë.
- PULË** DETI Shpend i madh shtëpiak, me pupla zakonisht në ngjyrë të errët e pikapika, me krahë të shkurtër, me kokën dhe një pjesë të qafës pa pupla, që rritet kryesisht për mish; femra e gjelit të detit, bibë, misëroke.
- PULË** DUSHKE Shaptore, shapkë.
- PULË** E EGËR Shpend i egër me trup sa një pëllumb, me pendë zakonisht ngjyrë kafe në të kuqërremtë, me kokën të verdhë me njolla të murrme e me sqep ngjyrë kafe

- të mbyllur, që jeton në pyje të mëdhenj; femra e gjelit të egër.
- PULË** HINI Pulëhine.
- PULË** UJI Shpend i egër, i ngjashëm me shaptooren, me këmbë të gjata, që jeton në vende moçalore dhe ushqehet me peshk.
- PULËBARDHË** f. 1. Shpend uji, me trup pothuaj sa një pulë, me këmbë të shkurtra, me pendë të dendura e të bardha, që fluturon shpejt, rron në brigjet e deteve a të liqeneve dhe ushqehet me peshk; çafkëbardhë. Tufë pulëbardhash. Klithma e pulëbardhave.
- PULËDUSHKE** f. Shapkë, shaptoore.
- PULORË** vet. Familje shpendësh, në të cilën hyjnë pula, shaptoerja etj.
- PUMË** f. Kafshë e egër mishngrënëse, e ngjashme me luanin, me gëzof ngjyrë hiri në të kuqërremtë, pa krifë e pa xhufkë në bisht, e cila jeton në pyjet e Amerikës dhe sulmon sidomos delet; macja e egër amerikane, luani i përhimët a ngjyrë argjendi.
- PUPË** V f. Pupëz.
- PUPËZ** f. 1. Zog shtegtar me trup sa të pëlumbit, të mbuluar me pupla të ndritshme e ngjyra-ngjyra, me sqep të gjatë e të hollë dhe me një xhufkë në kokë. Kënga e pupëzës. Pupëzon pupëza.
2. Çafkëlore.
- QAFËGJATË** f. Shpend uji i madh, i ngjashëm me çafkën, me qafë të gjatë, me pendë të bardha, me këmbë të murrme e me sqep të zi, të cilit në dimër i bien puplat e qafës dhe i zverdhët sqepi. Qafëgjata e madhe. Qafëgjata e vogël.
- QEFULL** m. 1. Peshk i ujërave të kripura dhe të ëmbla, me kokë pak të shtypur, me trup të gjatë e të hollë, të mbuluar me luspa të mëdha ngjyrë hiri të mbyllur në kurriz e ngjyrë argjendi në anët, i cili ka mish të shijshëm. Qefull i bardhë. Qefulli i verës cumër. Qefulli i vjeshtës kryegjati.
- QELBËS** m. 1. Gjitar i egër sa një shqarth, me hundë të ngritur, me lëkurë në ngjyrë të çelur në pjesën e sipërme dhe të errët poshtë, që ha minj, pula etj. dhe që lëshon një erë të keqe për t'u mbrojtur nga egërsirat e tjera. Lëkura e qelbësit.
- QEN** m. 1. Kafshë gjitare shtëpiake, mishngrënëse, me trup mesatar, që ka nuhatje shumë të mirë, që afrohet shpejt me njeriun dhe që mbahet për të ruajtur shtëpinë, bagëtinë etj., për gjah e për punë të tjera. Qen i bardhë (i zi). Qen besnik. Qen i tërbuar. Qen stani. Qen bariu. Qen gjuetie lingua, zagar. Qen kufiri. Qen race. Qen rrugësh. Tufë qensh. Kasollja e qenit. Qeni leh (angullin, kuit). E hëngri (e kafshoi) qeni. Lidh (lëshoj) qenin. Mbaj qen. I lëshoi qentë nga pas. Jetë qeni jetesë shumë e keqe. Gjumë qeni gjumë i keq, me shqetësime të shumta. Gjellë qensh ushqim i gatuar shumë keq, gjellë pa shije. Not qeni not duke lëvizur me shpejtësi brenda në ujë duart të përku-lura përpara gjoksit. Dridhet si qen dridhet shumë (nga të ftohtët ose nga frika). Rron si qen jeton shumë keq. Hahen (zihen) si qentë. E la (e braktisi) si qen rrugëve.
- QEN** DETI Peshkaqen.
- QIFT** m. 1. Shpend i madh grabitqar, me krahë të mëdhenj zakonisht të zinj, me kokë si në të bardhë, me sqep të kthyer e me bisht të bigëzuar, që ushqehet me kafshë të vogla e me zogj. I shpejtë si qift.
2. krahin. Skifter.
- QIME** f.
9. Qime e gjallë.
Qime e gjallë krimb i hollë si fije, që jeton në ujë dhe si parazit te disa kafshë shtëpiake e shpendë.
- QIMEGJALLË** f. Qime e gjallë.
- QOFKË** f. Mëllenjë. Qofka e murrme mëllenja e zezë. Grackë për qofka.
- QOK** m. shih GJON, ~I.

QOKAÇ m. 1. Qukapik, pikth.

QOLE II f. Zog këngëtar i ngjashëm me laureshën, që jeton nëpër ara dhe në drurë.

QUKAN m. Gjel deti.

QUKAPIK m. Zog që jeton në zgavrat e drurëve nëpër pyje dhe që ka sqep të gjatë e të fortë, me të cilin godet lëvoren e drurëve që të nxjerrë krimba e kandrra për t'u ushqyer; pikth, bredrurë. Qukapik i gjelbër (larosh, i zi). Fole qukapiku.

QUKË II f. 1. Pulëdeti, misëroke.
2. krahin. Kukuvajkë.

QUKËL f. 1. Qukë e vogël.
2. Mëllenjë e zezë.

QYQE f. 1. Zog shtegtar i pyjeve, me pendë ngjyrë hiri në të zezë, me sqep të përkuhur e me këmbë të shkurtra, që këndon me një zë të përvajshëm dhe që nuk bën fole, por i lëshon vezët në çerdhet e zogjve të tjerë. Zëri i qyqes. Kënga e qyqes.

Kali i qyqes huta e bardhë. Lot qyqeje kokërr e vogël si gogël, që bëhet në gjetet e ahut. Lule qyqeje bot. shih te LUL/E,~JA. Misër qyqeje bot. këlkazë. Rrushi i qyqes bot. shih te RRUSH,~I.

QYRLEK m. Kllinzë.

RABECKË f. Harabel. Çerdhe rabeckash. I vogël sa një rabeckë.

RACË f.

2. Grup kafshësh, zakonisht shtëpiake, që kanë tipare e cilësi të përbashkëta të trashëgueshme, të cilat zhvillohen nën ndikimin e mjedisit dhe përmirësohen me punën e kujdesin e njeriut. Racë e pastër (e përzier, e mirë, e keqe). Racë kuajsh (lopësh, dhensh, derrash, pulash ...). Përmirësimi i racës. Kryqëzimi i racës. Nxjerr një racë të re.

3. Grup kafshësh shtëpiake me tipare të jashtme dhe me cilësi prodhimi shumë të mira, lloj i zgjedhur. Kalë (dele, qen ...) race. Lë (mbaj) për racë.

RENË f. Lloj dreri i vendeve veriore me brirë shumë të degëzuar, që mbahet për qumësht, për mish dhe për të tërhequr rrëshqitëset. Kope renash. Rene shtëpiake (e egër). Qumësht rene.

RIGASH m. krahin. Gjeldet.

RIKAN m. Mashkulli i rosës, rosak. Rika e rikani.

RIKË f. 1. Zog rose, bibë rose; rosë.
2. Pulëdeti.

RINOQERONT m. Kafshë gjitare barngrënëse e viseve të nxehta të Afrikës e të Azisë, me trup të madh e me kokë të zgjatur, që ka në turi një bri a dy brirë; hundëbri. Rinoqeront afrikan (indian).

RIPËRTYPËS mb. 1. Që e kthen ushqimin nga stomaku dhe e përtyp për së dyti në gojë (për disa kafshë si kau, lopa, dhia, delja etj.). Kafshë ripërtypëse. Gjitarë ripërtypës.

2. si em. kryes. ~, ~IT. Kafshë që e përtypin për së dyti në gojë ushqimin që kanë ngrënë. Plëndësi i ripërtypësve.

ROSAK m. Mashkulli i rosës. Rosak i bardhë (i zi).

ROSË f. 1. Shpend uji me qafë të shkurtër, me sqep të gjerë, të rrafshët e të verdhë dhe me këmbë si pëllëmbë të hapura anash. Rosë e bardhë (e zezë). Rosë laramane. Rosë shtëpiake. Rosë e egër shpend ujë i egër me trup më të vogël, me kokë e me qafë të murrme në të kuqe dhe me kurriz të përhimë; zhytarak. Rosë deti lloj rose me trup më të madh se rosa e zakonshme e me sqep më të gjatë. Zog (bibë) rose. Vezë (mish) rose. Tufë rosak. Gjuetia e rosave. Ecën si rosë.

RRA f. Rre.

RRAJË f. Peshk me trup të gjerë, me lëkurë të fortë, që e ka kokën si të breshkës.

RRAJZË f. krahin. Glistër, krimb shiu.

RRAXHË II f. Peshk deti me trup petashuq në trajtë rombi që ka bisht të hollë e të gjatë.

- RRE** II f. Krimb që jeton si parazit në zorrët e fëmijëve, bubë. Bar rresh. Zuri rre. Nxori rre.
- RREMË** mb. Këmbë të rreme. zgjatime që u shërbejnë disa kafshëve të vogla në vend të këmbëve.
- RREZE** f.
9. Secila nga pjesët e forta, që përbëjnë skeletin e pendëve të peshqve. Rrezja e parë (e fundit). Rreze të forta (të buta). Rrezet e pendëve kurrizore (të barkut).
- RRËFESHK** m.
2. Kryeartëz, ferracak. Zog rrëfeshku.
- RRËQEBULL** m. Kafshë e egër mishngrënëse e ngjashme me macen, me trup deri një metër të gjatë, me qime të butë, të dendur e me ngjyrë të murrme lara-lara, me veshë të ngritur e me bisht të shkurtër; luqerbull. Lëkurë rrëqebulli. Me sy prej rrëqebulli. Ujkun e ndjek rrëqebulli.
- RRËSHAJË** f. Nepërkë. Me shtatin të hollë si rrëshajë.
- RRËSHQANËS** m. 1. shih RRËSHQANOR, ~I.
- RRËSHQANOR** m. zak. Zvarranik. Rrëshqanorët tokësorë (ujorë).
- RRËSHQANOR** mb. 1. Zvarranik. Kafshë rrëshqanore.
- RRIME** f. Krimb shiu. Ishte si rime.
- RRIQËR** f. Këpushë. Rriqra e zgjebes. Ka zënë rriqra. I hoqi rriqrat. Iu ngjit (iu qep) si rriqër iu qep pas e nuk i ndahet.
- RRUMBULLAKËT** mb. Krimbat e rrumbullakët.
- SALAMANDËR** f. Kafshë e vogël, që jeton në ujë dhe në tokë, e ngjashme me hardhucën, me bisht dhe me lëkurë të zezë ose me njolla të verdha; pikëlore. Salamandër e zezë. Bishti i salamandrës.
- SALMON** m. Peshk i madh i deteve të ftohta, me mish të kuq e të shijshëm, që largohet nga deti e futet në lumenj në kohën e riprodhimit. Salmon i kripur (i tymosur, i konservuar). Mish salmoni.
- SARDELE** f. Peshk i vogël deti që jeton në tufa të mëdha, me mish të shijshëm e që përdoret shpesh i konservuar. Sardele në vaj ulliri. Një kuti sardele. Tufë sardelesh. Gjuetia e sardeles.
- SEPJE** f. Butak deti me trup vezak si qeskë e vogël, që ka dhjetë brirthe rreth gojës, një guaskë të brendshme dhe një fshikëz me lëng të zi, të cilin e lëshon për të turbulluar ujin që të mbrohet.
- SFUNGJER** m. 1. Kafshë deti shumëqelizore me ndërtim të thjeshtë, që rron e ngulur së bashku me të tjerat në një skelet të lehtë e tërë vrima prej lënde të brirtë ose gëlqerore. Lloje sfungjerësh. Koloni sfungjerësh. Nxjerrin sfungjerë nga deti.
- SFURK** m.
2. Akrep. E kafshoi sfurku.
- SISOR** m. shih te GJITAR, ~I 1,2.
- SKADHINË** f. Peshk deti i madh, me trup të gjerë e të shtypur dhe me pendët e gjoksit të mëdha.
- SKIFTER** m. 1. Shpend grabitqar me sqep të kthyer e me kthetra të fuqishme, që rron nëpër shkëmbinj; fajkua. Skifteri kthetrazi. Krahët e skifterit. Ra në thonjtë e skifterit.
E rrëmbeu skifteri. Hidhet (sulet) si skifter.
- SKILE** f. 1. Dhelpër. Lëkurë skileje. Strofka e skiles. Këlyshët e skiles.
- SKLLOP** I m. Shpend uji i murrmë, i madh sa një pulë. Skllopat me sqep të gjatë.
- SKOBUZ** m. Njilë. Skobuzi i liqenit të Pogradecit. Rritja e skobuzit.
- SKORT** m. Peshk i vogël i ujërave të ëmbla, me trup të zgjatur dhe të shtypur anash, me kokë të shkurtër e me turi të hollë. Skort i bardhë gurnec. Skorti i zi.
- SKRAPTH** m. 1. Gjarpër helmues me trup të hollë, me ngjyrë të verdhë në të kuqërremtë dhe me një njollë rrëzë fytit. E zuri skrapthi.
2. Kandërr e zezë helmuese, që i ngjan brumbullit.

- SKUMBRI** f. Peshk deti deri gjysmë metri i gjatë, me ngjyrë blu të shkëlqyeshme dhe me vija të gjelbra, me mish të bardhë e të shijshëm.
- SOKOL** m. 1. Shpend grabitqar me sqep të kthyer dhe me krahë e thonj të fuqishëm; petrit. Sokoli kthetrazi. Hidhet si sokol.
- SORKADH** m. 1. Kaproll. Sorkadh mali. Hidhet (kërcen, vrapon) si sorkadh.
- SORKADHE** f. 1. Femra e kaprollit, kaprolle. Sorkadhe mali. E lehtë si sorkadhe. Ngjitet si sorkadhe.
- SORRAK** m. Mashkulli i sorrës.
- SORRË** f. 1. Shpend me pendë të zeza të ndritshme e me sqep të kthyer, që ndërton çerdhe nëpër godina të braktisura e mbi drurë të lartë dhe që dëmton të mbjellat e pemët. Tufë sorrash. Krakërijnë sorrat. Është veshur me të zeza si sorrë.
- SOVAL** m. Kastriq.
- SPALCË** f. Peshk deti me trup të gjerë e të shtypur anash, me luspa të ndritshme si argjend, me mish të bardhë e të shijshëm; kocë e vogël.
- SPURDHIQ** m. Spurdhjak.
- SPURDHJAK** m. 1. Trumcak, harabel; zog i vogël në përgjithësi. Shpërndahen si spurdhjakët.
- SQEPADRUTH** m. Qukapik.
- SQEPGJATË** f. 1. Shpend i brigjeve të detit me trup mesatar, me kokë dhe qafë të zezë, me bark të bardhë e me sqep të kuq.
- SQEPKUQ** mb.
* Korb sqepkuq shih te KORB, ~I.
- SQEPLUGË** f. Lloj rose e egër me pendë të bardha dhe me sqep të madh, të gjerë e si lugë, e cila rron zakonisht nëpër kënetat.
- SQEPTORE** f. Shaptore, shapkë.
- SQEPTRASHË** m. Zog i ngjashëm me trumcakun, me pendë të murrme në të kuqërremta, me gushë të bardhë dhe me sqep të trashë e shumë të fortë.
- STËRQOK** m. Mashkulli i stërqokës.
- STËRQOKË** f. Shpend i familjes së korbave, me trup pak më të vogël se sorra, me bisht të gjatë, me pendë të zeza në trup e të bardheme në qafë e në bark; cirikokë. Stërqokë mali.
Një tufë stërqokash.
- STRAGË** f. Kubël në moshën mbi një vit deri në pjekjen seksuale.
- STRUC** m. Shpend me trup të madh, me krahë pak të zhvilluar, me qafë e me këmbë të gjata, që vrapon shpejt dhe që rron në shkretëtira e në stepat e vendeve të nxehta. Pupa struci.
- SUTË** f. 1. Femra e dredit, drenushë. Sutë e plagosur. E shkathët (e hajthme) si sutë mali.
- SUVAL** m. Gjarpër i madh e i trashë që përmendet në tregimet popullore, në të cilat thuhet se i mbështjell kafshët dhe u zë frymën.
- SHAPKË** III f. Shaptore, pulëdushke. Shapkë ujëse (uji) lloj shpendi i tillë, që rron nëpër moçalishte.
- SHAPTORE** f. Shpend i murrme lara-lara, me sqep të gjatë, të hollë e të drejtë, që rron nëpër shkorrete e pyje me lagështirë dhe ka mish të shijshëm; shapkë, pulëdushke.
- SHARDE** f. shih BOLLËSHARD/E, ~JA.
- SHARRUES** m.
2. Sharruesi i drithërave: insekt shumë i vogël me ngjyrë të zezë, me unaza të verdha në trup e me krahë të tejdukshëm, që dëmton drithërat.
- SHIGJETË** f.
7. Shigjetull.
- SHIGJETULL** f. Një lloj gjarpri i gjatë helmues, me ngjyrë si në të verdhë, që hidhet si shigjetë.
- SHIMPANZE** f. Majmun i madh që rron në pyjet e Afrikës tropikale, që i ngjan më shumë njeriut dhe është më i zhvilluar e më i zgjuar se majmunët e tjerë.

SHIRIT m.

3. Krimb i gjatë me trup të përbërë prej një numri të madh unazash të shtypura, që jeton si parazit në zorrët e njeriut dhe të disa kafshëve gjitare; lëvrizë. Shiriti i njeriut (i kaut, i dërrit, i qengjave, i qenit). Koka e shiritit. I daltë shiritit! mallk.

SHKABË f. 1. Shpend i madh grabitqar me ngjyrë të përhime në të kuqërremtë, me qafë të zhveshur, me sqep të kthyer e me kthetra të forta, që ushqehet më tepër me kafshë të ngordhura. Fole shkabe. E hëngrën shkabat.

2. Shqiponjë.

SHKATËRR f. Peshk deti i madh e grabitqar, me trupin petashuq e pa luspa, me bisht të mprehtë dhe i pajisur me organe që prodhojnë shkarkime të forta elektrike. Shkaterra nuk ahahet.

SHKËNDIJË f.

5. Xixëllonjë, shkëndijëz. Dolën shkëndijat.

6. Kandërr me trup të zi ose ngjyrëkafë të hapur, me flatra të mëdha e me këmbë të gjata, që shfaqet në kohën e lulëzimit të pemëve dhe dëmton lulet e tyre. Mollet i dëmtoi shkëndija.

SHKËNDIJËZ f. 1. Xixëllonjë. Zuri një shkëndijëz. Cilivili-vileza / dilni moj shkëndijëza! kr. pop.

SHKRAP m. krahin. Akrep, surfur.

SHKURTË I f. Zog shtegtar që i ngjan thëllezës, me pendë të murrme e lara-lara, me këmbë të shkurtra dhe me mish shumë të shijshëm; shkurtëz. Shkurtë pikaloshë. Ecën si shkurtë.

SHKURTËZ f. 1. Short që hidhet me disa fije druri, kashte etj., njëra nga të cilat është më e shkurtër se të tjerat. Shtinë (hodhën) shkurtëzën. I ra shkurtëza.

2. Shkurtë.

SHLLIGË f. 1. Nepërkë. Të hidhet si shlliga.

SHOJZË I f. Peshk i ujërave të kripura e të ëmbla, me trup vezak e petashuq, i murrme nga sipër e në të bardhë nga poshtë, me të dy sytë të vendosur nga ana e djathtë e trupit dhe me mish të shijshëm.

SHOTAN m. krahin. Mashkulli i shotës.

SHPEND m. 1. Kafshë kurrizore me trup të mbuluar me pendë e me pupla, me dy krahë, me dy këmbë e me sqep, që bën vezë dhe që në përgjithësi mund të fluturojë; klasa e këtyre kafshëve. Shpendët shtëpiakë. Shpendët e egër. Shpendë shtegtarë (të përhershëm, endacakë). Shpendë ujës (uji). Shpend i balsamosur. Shpend deti. Shpend gjahu. Mish shpendësh. Plehu i shpendëve. Shtimi i shpendëve. Rritësit e shpendëve. Thertore shpendësh. Sëmundjet e shpendëve.

SHPENDKEQ m. Kukuvačkë, herëkeqe. Shpendkeqi këndon natën.

SHPESË f. Shpend. Shpesët shtëpiake. Shpesët e egra.

SHPUES m.

* Shpuesi i frutave insekt i vogël, me trup në ngjyrë qielli të errët, të mbuluar me qime të shkurtra e të rralla, i cili dëmton mollët, dardhët, kajsitë, pjeshkat, kumbullat etj.

SHQARTH m. Kafshë grabitqare më e vogël se dhelpra, me gëzof të çmueshëm, zakonisht në ngjyrë të murrme, që ngjitet me shkathtësi nëpër pemë dhe ha pulat; kunadhe; gëzofi i kësaj kafshë. Lëkurë (gëzof) shqarthe. Ngjitet (rëshqet) si shqarthe.

SHQEPADRU m. Qukapik.

SHQIPE II f. 1. Shqiponjë. Shqipja arbërore. Shqipja dykrenore. Shqipe mali. E rrëmbëu shqipja. U vërsul si shqipe.

SHQIPONJË f. 1. Shpend i madh grabitqar, me sqep të kthyer, me kthetra të gjata e të forta dhe me sy të mprehtë, që rron në male e në stepa dhe mbahet nga shqiptarët si simbol i lirisë e i trimërisë; shqipe, shkabë. Shqiponjat e maleve

tona. Krahët (kthetrat) e shqiponjës. Sy shqiponje. Fole shqiponje. Sulet si shqiponjë. Më mirë shqiponjë një ditë, se sorrë një vit. fj. u.

SHQIPONJË DETI Fregatë.

SHQIRËZ f. Thëllëzë fushe.

SHTËRPI m. kryes. Zvarranik, rrëshqanor (si gjarpri, zhapiu, hardhuca etj.). Ikën shtërpinjë.

SHTREP m. kryes. Krimba të vegjël e të bardhë, që zë një lloj djathi. Djathë me shtrepa.

SHTRIGË f.

3. Flutur që hyn natën në koshere dhe ha mjaltin; flutur nate që tërhiqet nga drita e vjen rreth llambës.

* Kalë shtrigash (shtrige) shih te KAL/Ë,~I. Zog shtrige (zog ferre, zog miu) shih te ZOG,~U.

SHTURË f. Zog i vogël shtegtar, i ngjashëm me harabelin, me pupla të zeza e me cirka të bardha në krahët e në bark, me sqep të shtypur në majë, i cili është shumë i shkathët e i lëvizshëm dhe këndon bukur.

SHUMËKËMBËSH m. 1. Kafshë e vogël, me trup të ndarë në shumë unaza, të cilat kanë çdonjëra nga një palë ose nga dy palë këmbë të nyjtuara; këmbëshumëz, dzyzetkëmbësh.

SHUSHUNJË f. 1. Krimb parazitare i ujërave të ëmbla, me trup unazor shumë të zhdërvjellët, që ushqehet me gjakun e kafshëve të ndryshme duke u ngjitur në trupin e tyre dhe që përdoret edhe në mjekësinë popullore për të marrë gjak. Shushunjë mjekësore. Shushunjë kali. Lëshoi (vuri, hodhi) shushunjat. Të ngjitet si shushunjë. keq. (për një njeri që të qepet e s'të ndahet). Shushunja e dardhës kandërr me ngjyrë të zezë të ndritshme e me flatra të tejdukshme, që dëmton dardhën, vishnjën, qershinë e pemë të tjera. Shushunja e të lashtave (e drithërave) lloj buburreci me ngjyrë blu në të gjelbër e me shkëlqim metalik, që dëmton të lashtat.

TAKLLORE f. Qukapiku, pikthi; femra e qukapikut.

TAMBLUC m. Lloj hardhuce e vogël, me kokë të madhe, me sy të mëdhenj e me këmbë të shkurtra, që rri nëpër mure e në faqet e shkëmbinjve.

TARTABIQE f. 1. Kandërr vogël me trup të rrumbullakët e të shtypur, me ngjyrë vishnje të errët e me një erë të rëndë, që jeton si parazit në banesa, nëpër plasat a vrimat e mureve, të dërrasave, të shtretërve etj. ose në vende të errëta dhe që u thith njerëzve gjakun kur flenë; çimkë. Bar tartabiqesh. Erë tartabiqeje. Krevat me tartabiqe. Ka tartabiqe dhoma. Zhduk (mbyt) tartabiqet.

TENJË f. 1. Flutur me madhësi e ngjyra të ndryshme, që e ka larvën si vemje të hollë dhe që bren e dëmton shumë bimët ose ushqehet me dyllin e bletëve, me miell etj.

TERMITE f. vet. Miza të mëdha si milingona, me trupin të mbuluar me një cipë, që rrojnë bashkë në vende të nxehta dhe ndërtojnë fole zakonisht nëpër drurë. Termitet e mëdha.

TETËKËMBËSH m. Butak deti pa guaskë, me trup të mbledhur si qeskë, të butë e pa hala, me tetë krahë, me ventuza e me dy sy të mëdhenj, që lëshon një lëng të zi për t'u mbrojtur; likurishtë, oktapod.

TIGËR m. 1. Kafshë e madhe grabitqare e familjes së maceve, me trup të gjatë e të mbuluar me qime të verdha në të kuqe, me breza të zinj për së gjeri dhe me bisht të gjatë, që jeton në Azi (kryesisht në Indi). Gjuetia e tigris. Lëkura e tigris.

TOJË II f. Kurrillë. Tufë tojash. Fluturimi i tojave.

TOKË I f. vet. nj. Mizë toke (dheu) milingonë.

TON II m. Peshk i madh grabitqar, deri në pesë metra i gjatë e me peshë deri në pesëqind kilogramë, me kurriz në ngjyrë blu të errët e me bark pulla -pulla, që

- rron zakonisht në detet e ngrohta. Gjuetia e tonit. Konserva toni.
- TRËNDAFIL** m. Trëndafil deti shih FIL-LIKAT/E, ~JA.
- TRINGEC** m. Trishtil.
- TROFTË** f. Peshk grabitqar i ujërave të ëmbla, me trup të gjatë e me dy fletë në shpinë, me gojë të madhe e me nofulla të forta, që e ka mishin zakonisht pak si të kuqërremtë dhe shumë të shijshëm; koran. Trofta pikaloshë. Troftë liqeni (lumi). Trofta e malit. Gjuetia e troftave.
- TRUMCAK** m. Harabel. Trumcaku i zakonshëm. Trumcaku i livadheve. Cicërima e trumcakut. Tufë trumcakësh. Sa një trumcak.
- TUNDUBISHTJE** f. Bishtatundës.
- TURTULL** m. Zog shtegtar, më i vogël se pëlumbi, me kokë të vogël, me bisht të gjatë e me pendë të përhime, që jeton nëpër pyje e që këndon bukur. Mish turtulli.
- TUSHË** f. Lloj mëllenje, me sqep të drejtë të shtypur e të verdhë, me pupla të zeza e me lara të bardha në krahët, në bark dhe nën bisht që jeton në tufë. Tushë mali lloj mëllenje me pupla të përhime që rron më shumë në male.
- THËLLËZË** f. 1. Zog i madh sa një pëlumb, zakonisht me ngjyrë të murrme në të përhime me sqep të kuq, që jeton në tufa fushave e maleve dhe që këndon bukur. Thëllëzë mali (fushë). Mish thëllëzë. Tufë thëllëzash. E bukur si thëllëzë. Këndojnë thëllëzat. Doli për thëllëza. Ecën si thëllëzë.
- THITHAK** m.
2. Thimthi i kandrrave. Thithaku i bletës.
- THITHËLOPË** f. Një lloj bretkose e madhe, me lëkurë të gjelbër e tërë rrudha, e cila jeton në ujë vetëm gjatë kohës së shumëzimit dhe për të cilën besohej se i ngjitej lopës në sisë e ia thithte qumështin.
- THIUL** f. Një lloj rose e egër, me kokë të madhe e me qafë të trashë.
- THJESHTË** mb. Kafshët e thjeshta. kafshë që i përkasin një faze të ulët të zhvillimit biologjik.
- THNEGËL** f. Milingonë, mizë përdhese, mizë dheu. Fole thneglash. Mblidhen si thneglat mblidhen me shumicë në një vend.
- THUMBUES** mb.
4. si em.~, ~I m. kryes. ~, ~IT Rendi i kandrrave që kanë thumb.
- THUMBVERDHË** mb. 1. Sqepverdhë.
2. si em. THUMBVERDH/Ë,~A f. A, ~AT Mëllenjë thumbverdhë.
- THUNDRAK** mb. 1. Që ka thundër. Kafshë thundrake.
2. si em.~, ~ U m. kryes. ~Ë, ~ËT Rend gjitarësh, ku hyjnë kafshë me trup të madh si kali, gomari, kau, delja etj., që kanë thundra në fund të këmbëve.
- THUNDROR** mb. Thundrak. Kafshë thundrore.
- UDHORE** f. Lloj peshku trupvogël e petashuq, i ngjashëm me kocen.
- UJK** I m. 1. Kafshë e egër mishngrënëse, e ngjashme me qenin, me qime të përhime në të verdheme, me veshë të drejtë e me majë, që sulmon shpesh bagëtitë.
- ULLI** m. bot. Miza (breshkëza...) e ullirit.
- UNAZË** f.
5. Çdonjëri prej rrathëve që përbëjnë trupin e disa krimbave, të disa kandrrave e të disa kafshëve të tjera që nuk kanë eshtra; rreth. Unazat e krimbit të shiut. Unazat e shushunjës. Unazat e barkut të bletës.
- UNAZOR** mb.
2. Që e ka trupin të përbërë prej unazash (për disa krimba, kandrra e disa kafshë të tjera). Krimb unazor krimbi i shiut. Flu-tur unazore. Bark unazor.

- UNAZORE** f. Flutur me krahë dhe me trup zakonisht në ngjyrë të verdhë, që dëmton pemët, sidomos mollën dhe dardhën. Unazorja e pemëve.
- URITH** m. 1. Kafshë e vogël gjitare, me turi të zgjatur me këmbët e para si lopatë, me sy shumë të vegjël e me qime të dendura e të ndritshme, që jeton në tokë e gërmon dheun dhe që ushqehet me kandrra. Urithi i tokës. Vrimë urithi. Gërmon si urith. I ka sytë si të urithit nuk sheh mirë.
- USHUNJËZ** f. Shushunjë. Hedh ushunjëza. I pi gjakun si ushunjëz.
- VAMPIR** m.
4. Një lloj lakuriqi i natës me trup të madh, që jeton në Amerikën Jugore dhe ushqehet me gjak.
- VAPJE** f. 1. Harrje.
- VARDUA** m. Lloj harabeli këngëtar, i ngjashëm me borësin, që i ka pendët në ngjyrë të gjelbër të mbyllur dhe që rron nëpër pyje e nëpër kopshte.
- VELËZ** f. Verzë peshku. Velëzat e kokës. Kapakët e velëzave. Merr frymë me velëza.
- VEMËZ** f. Bleta punëtore.
- VEMIZË** f. Vemje.
- VEMJE** f. 1. Larva e disa kandrrave, që ka trajtën e një krimbi me disa unaza; larva leshtore e disa fluturave, që dëmton pemët e barishtet; dhemizë. Vemja e kumbullës (e rrushit, e pjeshkës, e agrumeve). Vemja e dushkut. Vemja e panxharit (e lakrës, e bizeles). Vemja e jonxhishteve.
2. Mizë që lëshon vezët në mish; vezët e kësaj mize. E pështyu vemja.
- VERDHASH** mb.
2. si em.~, ~I m. ~Ë, ~ËT Bengu.
- VERË** I f. Korani i verë shih te **KORAN**,~I. Qefulli i verës shih te **QEFULL**,~I.
- VERORE** II f. Zhabë e vogël me ngjyrë të gjelbër, që del e kuak në fillim të pranverës. Veroret e kënetës. Këndojnë veroret.
- VERTEBROR** mb. Kurrizor. Shtylla vertebrorë. Kafshët vertebrorë.
- VERTEBRORË** m. vet. Kurrizorët. Vertebrorët e ulët. Zhvillimi i vertebrorëve. Zoologjia e vertebrorëve.
- VERZAKUQ** m. Pendëkuqi.
- VERZË** I kryes. Organet që kanë peshqit e disa kafshë të tjera në të dy anët e kokës nën vesh, që hapen e mbyllen dhe që u shërbejnë atyre për të marrë frymë në ujë. Verzat e kokës. Kapakët e verzave. I heq verzat.
- VESHVERDHË** m. Lloj qefulli me trup të vogël, që i ka kapakët e verzave me nga një pikë të verdhë, veshar.
- VETH** m. Vemja që lëshohet nga një mizë në mish dhe e prish këtë. Ka vënë veth mishi e ka pështyrë miza mishin.
- VEZULLONJË** f. Xixëllonjë.
- VEZULLORE** f. Xixëllonjë.
- VIDAN** m. Pëllumb mashkull. Gugat vidani.
- VIDË** I f. 1. Pëllumb femër, pëllumbeshë. Vida e bardhë.
- VIDËR** f. 1. Lundër. Vidër lumi. Gëzof vidre.
- VIJË** f. Vija anësore organ i ndijimit te peshqit e te disa kafshë të tjera të ujit, që përbëhet prej një vargu vrimëzash në anët e trupit. Vijë formuese mat. vijë nga lëvizja e së cilës krijohet një sipërfaqe. Vija e verdhë ndërt. kufiri brenda të cilit lejohen ndërtimet në një fshat a në një qytet.
- VIJOSH** m. Lloj qefulli me pesë deri shtatë vija gjatësore në trup e me buzë të dala, buzaç.
- VIRRMËKEQE** f. Kukuvačkë.
- VJEDULL** f. Baldosë.
- VOGËL** mb.
10. Përdoret si pjesë e dytë e disa emërtimeve të pathjeshta, që tregojnë zakonisht një lloj insekti dëmtues. Barishtori i vogël. Grerëza e vogël. Syri i vogël. Biruesi i vogël. Brumbulli i vogël i duhanit. Tenja e vogël e rrushit.

VONGOREC m. Koshëz.

VRESHT m. Kërmilli i vreshtave.

VUSHË f. Kacabun që rri nëpër plehra; Brumbull plehu.

XIXËLLIMË f.

3. Xixëllonjë.

XIXËLLONJË f. 1. Kandërr e vogël; e murme, me trup të shtypur e cila e ka pjesën e fundit të barkut të verdhë dhe ndrit si një xixë që ndizet e shuhet natën në filim të verës; shkëndijëz, bukurezë. Në maj dalin xixëllonjat. Kapin xixëllonja;

XHIXHIMËS m. Trumcak, harabel.

YLL DETI Kafshë deti me trup të shtypur, që ka pesë a më shumë rreze.

ZAKONSHËM mb. Karkaleci i zakonshëm.

ZARDAF m. Kafshë grabitqare e ngjashme me shqarthin, por me trup më të madh e me putra më të gjera, me lëkurë në ngjyrë gështenje të mbyllur, të shkëlqyer e të çmueshme, me një pullë të verdheme nga mjekra deri në gjoks, që jeton në pyje malore. Lëkurë zardafi. Strofkë zardafi. Këlysh zardafi.

ZARIGOGË f. Bregcë. Fole zarigogash.

ZBORAK m. Borës. Cicëron zboraku.

ZBORAKËS m. Borës.

ZEBËR f. Lloj kali i egër shumë i shkathët, që e ka trupin vija-vija bardhë e zi dhe që rron në kope në Afrikë. Lëkura e zebrës.

ZEGAL m. shih ZEKTH,~I.

ZEGËL m. Zekth. I hyri zegli. I zuri (i pickoi) zegli.

ZEKTH m. 1. Kandërr me krahë, me trup sa një mizë e madhe, që fluturon me një zhurmë të veçantë dhe që gjatë pranverës e verës pickon gjedhin e i thith gjakun. Zekthi i zakonshëm. Pickimi i zekthit. E zuri zekthi.

ZGALEM m. 1. Shpend uji me pendë të bardha e të zeza, me krahë të ngushtë e të gjatë, me këmbë shumë të shkurtra, me bisht të bigëzuar dhe me sqep të kthyer, që fluturon mbi valët përpara e gjatë stuhisë. Zgalemi i stuhisë. Klithma e zgalemit. I guximshëm si zgalemi.

ZI mb. Miu i zi. Nepërka e zezë. Buburreci i zi. Mëllenja e zezë. Furrarja e zezë. Delfini i zi. Karkaleci i zi. Miza e zezë. Fasulja e zezë. Laramania e zezë racë lopësh.

ZILE f. Gjarpri me zile gjarpër helmues, që ka në fund të bishtit një hapësirë konike, me të cilën bën një zhurmë tingëlluese.

ZOG m. 1. Kafshë e vogël kërbishtore, me trupin të mbuluar me pupla, me sqep të birtë, me dy këmbë dhe me krahë për fluturim, që shumëzohet me anë të vezëve; emër i përgjithshëm për shpendët e vegjël si trumcaku, dallëndyshja, bilibili etj. Zog bari lloj shpendi i vogël, i egër, në ngjyrë të barit. Zog blete bregca. Zog bore (zog dimri) bores, zborak. Zog çaush zog arash me sqep të kthyer, me pendë në ngjyra të ndryshme dhe me kaçul mbi kokë. Zogu dervish lareshë me kaçirubë, çafkëlore. Zogu i dhenve bishtatundësi. Zog miu (zog ferre, zog shtrige) ferrës, cinxami. Zogu mizë kolibri. Zogu i natës lakuriqësi i natës. Zog nuseje (zog rrëfeshku) kryeartëza.

ZVARRANIK m. 1. Kafshë kërbishtore (si hardhuca, gjarpri, breshka etj.), zakonisht me trup të zgjatur, me këmbë të shkurtra ose pa këmbë, që lëviz duke u zvarritur për tokë; rrëshqanor; në klasa ku hyjnë këto kafshë. Klasa e zvarranikëve.

ZHABË f. Lloj bretkose, me trup pak më të madh se e zakonshmeja, që e ka lëkurën të murrme në të kuqërremtë, të mbuluar me puçrra me helm dhe që rron zakonisht në toka me lagështirë; bretkose.

ZHABJAK m. 1. Zhapi.

2. Thithëlopë.

ZHAPI m. Lloj hardhjeje, me trup të madh dhe me shpinë të blertë me pika të bardha a të murrme; hardhja e blertë. Fshihet si zhapi. I ka sytë si të zhapiut.

ZHAPIK m. Zhapi.

ZHUZHAK m. 1. Kandërr me dy palë krahë, nga të cilët të sipërmit janë të fortë e të ndritshëm, ndërsa të poshtmit, që hyjnë në punë për fluturim, janë të hollë; vizhë. Zhuzhaku i gjelbër. Zhuzhaku i majit. Zhuzhaku i drithërave. Zhuzhaku i misrit. Zhuzhaku i hardhisë. Zhuzhaku lëvorengrenës.

ZHUZHINGË f. Vizhë, zhuzhak. Zuri një zhuzhingë.

ZHUZHULL m. Zhuzhak i zi që rron zakonisht në pleh, brumbulli i zi. Po t'i biesh pas zhuzhullit, do të shkosh në pleh. fj.u.

ZHYTARAK m. Lloj rose e egër, që i ka puplat e trupit të zeza dhe ato të qafës e të kokës të kuqërreme si ndryshku.

ZHYTËR f. Shpend uji, me trup të madh sa bajza, me krahë të shkurtër dhe me qafë të kuqe, që ushqehet me peshk.

ZHYTKRYEKUQE f. Shpend uji, me trup sa të bajzës, me kokën e pjesën e sipërme të trupit në ngjyrë të murrme në të zezë, me gushën e anët të kuqe në të murrme dhe me barkun të bardhë, që ushqehet me peshq.